

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

30.12.2020

Ora 10:10

RENDI I DITËS


Projektvendimi “Rregullat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, A.Tenolli, O.Peto**
- **Parti Politike PD, LSI**
- **Vëzhgues:**

Znj.I.Nano: Atëherë të nderuar kolegë mund të fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator. Janë të pranishëm në mbledhje të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, i pranishëm është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përfaqësues të Partive Politike dhe përfaqësues të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Mbledhja e sotme ka vetëm një pikë në rendin e ditës, do të duhet të shqyrtojmë dhe miratojmë “Rregullat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në

**Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

shërbim të zgjedhjeve”. Nëse një nga kolegët paraprakisht ka diçka lidhur me rendin e ditës? Po zoti Çakaj!

Z.M.Çakaj: E nderuar zonja Nano, në fakt unë kisha për diskutim një çështje tjetër jashtë rendit të ditës, kështu që nëse është e mundur ta diskutoj paraprakisht? Më pas vazhdojmë me rendin e ditës.

Znj.I.Nano: Doni të shtoni një pikë në rendin e ditës?

Z.M.Çakaj: Jo, është një diskutim jashtë rendit të ditës, ka të bëjë më shumë me një akt të miratuar nga Komisioni Rregullator dhe një sqarim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.


Znj.I.Nano: Po.

Z.M.Çakaj: Nëse mund të më lejoni, mund ta shtroj tani çështjen ta diskutojmë tani çështjen jashtë rendit të ditës?

Znj.I.Nano: Dakord, mund ta parashtroni tani dhe ta vlerësojmë nëse e diskutojmë tani apo mbasi të mbarojmë aktin që kemi në rendin e ditës.

Z.M.Çakaj: Dakord, çështja jashtë rendit të ditës ka të bëjë me aktin që kemi miratuar në datë 24 dhjetor, mbi “Veprimtaritë e ndaluara” dhe në fakt shkurtimisht duhet ta bëjë prezente çështjen. Siç jeni të gjithë në dijeni në datë 24 dhjetor, Komisioni Rregullator ka miratuar një në gjykimin e vlerësimin tim, por besoj dhe të anëtarëve të tjerë ka miratuar një nga aktet më të rëndësishme deri

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

më tani lidhur me identifikimin dhe pasqyrimin e “Veprimtarive të ndaluara” për të cilat së pari, nuk lejohet dhe së dyti, ato veprimtari të cilat do të kryejnë institucionet shtetërore, së pari të raportohen në ndërfaqet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe së dyti ti japi miratimin Komisioneri Shtetëror. Pra, raportohen pesë ditë më përpara dhe brenda tre ditësh përpara zhvillimit të veprimtarisë, do të duhet të jap miratimin Komisioneri Shtetëror. Çfarë ka ndodhur? Nga data 25 dhjetor që ka hyrë në fuqi akti, në gjykimin tim siç e sqarova një nga aktet më të rëndësishme deri më tani, lidhur me vendosjen e palëve përpara garës në kushte të barabarta. Një ditë më pas, personalisht më janë raportuar disa veprimtari të cilat në gjykimin e personave denoncues ishin të ndaluara. I kam referuar dhe në këtë pikë falenderoj dhe Komisionerin, që në kohë rekord brenda afatit të parashikuar e ka bërë funksionale ndërfaqen e raportimit dhe i kam orientuar të gjithë denoncuesit ta denoncojnë me materialet përkatëse në ndërfaqen e raportimit të KQZ, vlen të theksoj dhe dua ta veçoj një rast, i cili në një kohë kaq të shkurtër nga data 25 dhjetor që ka hyrë në fuqi akti, deri në datën 30 që sot po miratojmë një akt tjetër, është evidentuar në gjykimin tim, por kjo ngelet në gjykim të Komisionerit ta vlerësoj. Kemi dy raste të denoncimit për të njëjtin person, bëhet fjalë për një deputet të Parlamentit Shqipëtar, i cili në datën 26, në faqen zyrtare të facebook të tij ka promovuar shpërndarjen e lejeve të legalizimit dhe jo më vonë se dje ka promovuar përsëri shpërndarjen e lejeve të legalizimit. Tani unë këtu personalisht, sigurisht e kam orientuar denoncuesin ta raportojë dhe këtë rast në ndërfaqen e raportimit. Tani unë këtu gjej dy probleme kryesore, së pari shpërndarja e lejeve të legalizimit, të gjithë biem dakord dhe e kemi miratuar, është veprimtari e ndaluar dhe në respekt të aktit, së dyti dhe kjo bënë një çudi shumë të madhe. Lejet e legalizimit a janë një proces normal i nisur nga qytetari i cili ka aplikuar për leje për një ndërtim të paligjshëm dhe ka aplikuar pranë sporteleve fillimisht të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

ALUIZMIT dhe më pas pranë ASHK. Aty thuhet që një lejë legalizimi, qytetari apo personi i cili është i interesuar ta marrë lejen pranë sporteleve në zyrat e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës. Kush e ka bërë këtu, patjetër kemi të bëjmë me një Vepër Penale, shpërdorim detyre. Kush e ka bërë, specialisti, përgjegjësi i sektorit, drejtori i ASHK apo deputeti? Çfarë pune kanë lejet e legalizimit në duart e një deputeti, nuk ka as fare aspekt ligjor, nuk ka asnjë lloj legjislacioni shqiptar që ta marrë deputeti lejen e legalizimit dhe t'ia dorëzojë qytetarit dhe sigurisht kjo bëhet për përfitim. Unë nga ana ime e kam orientuar denoncuesin ta raportojë dhe besoj tani që po flasim është raportuar në ndërfaqen e raportimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe do të ftoja Komisionerin që ta shohë me prioritet këtë rast dhe të kryejë hetimin e duhur dhe të ndërmarrë, besoj sanksionet e duhura, ndaj të gjithë personave që kanë kryer dhe vazhdojnë të kryejnë shkelje të kësaj natyre, faleminderit e nderuar!

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Në këtë rast edhe ne si qytetar duhet të bëjmë denoncimet tona jo vetëm në cilësinë e anëtarit të Komisionit Rregullator. Kështu që dhe orientimi i qytetarëve për të raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, besoj se është detyrë e jona qytetare. Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Dy fjalë pas diskutimit të zotit Çakaj, të cilin e gjej jo vetëm me vend por falenderoj kolegun që e ngriti. Jo vetëm ai akt konsiderohet si një ndër aktet më të rëndësishme pasi veprimtaritë e targetuara ose etiketuar si të ndaluara, janë vlerësuar si të tilla me qëllim mbajtjen larg procesin zgjedhor, por me sa duket dhe këtë e ka bërë publike media, palët nuk e kanë konsideruar aktin tone, ose ende nuk kanë marrë masat për ta konsideruar. Do doja të theksoja një lançim që unë sapo e dëgjova në disa prej mediave vizive në televizione

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

kombëtare madje, i cili është pikënisje e një trumbetimi të ministrave të kabinetit që nën klamufimin e fjalës tender fsheh një koncesion apo lancon koncesione të reja. Në këtë moment do doja që Komisioneri të tregohet dhe administrata në të njëjtën kohë të tregohet e vëmendshme karshi këtij procesi dhe zbatimin e këtij akti me qëllim që ti lemë sens se përse u bë ai akt dhe të ndikojmë ashtu siç kishim qëllimin e mirë për miratimin e atij akti. Ta lëmë procesin zgjedhor në gjëndje të lirë ashtu siç duhet të jetë realisht, faleminderit!


Znj.I.Nano: Faleminderit zonja Vukaj. Komisioneri nëse dëshiron të thotë diçka në lidhje me çështjen që ngritën dy kolegët.

Z.I.Celibashi: Unë ju kërkoj ndjesë sepse për një arsye u shkëputa nga mbledhja nëse ka mundësi një përmbledhje shumë shkurt, ju kërkoj ndjesë.

Znj.I.Nano: Bëhet fjalë për zbatimin e veprimtarive së ndaluara nga Komisioni Rregullator. Zoti Çakaj dhe zonja Vukaj denoncuan disa raste. Zoti Çakaj i ka orientuar qytetarët të denoncojnë lidhur me ndalimin e një veprimtarie, parashikuar prej nesh si: shpërndarja e lejeve të legalizimit dhe në këtë rast nga persona të paautorizuar. Zonja Vukaj parashitroi një shqetësim që vjen nga një publikim në media drejtuar ndaj një institucioni Ministër Kabineti, për raste koncesioni. Ideja është ndoshta edhe një informacion i nderuar Komisioner, për funksionimin e ndërfaqes ka filluar të funksionojë edhe nëse ka ndonjë gjë tjetër që mund të bëjë Rregullatori në këtë moment?

Z.I.Celibashi: Atëherë për dijeninë tuaj por edhe për dijeninë e publikut, ndërfaqja është aktive që prej datës 25 dhjetor. Ne jemi duke punuar dhe bashkëpunuar

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

kryesisht në momentin e parë me institucionet kryesore të administratës publike, sikurse janë Kryeministria, ministritë dhe bashkitë, në lidhje me marrjen e informacioneve mbi personat e kontaktit, përgjegjës për raportimin në ndërfaqe. Në pjesën më të madhe të tyre kemi marrë informacion. Kemi krijuar llogaritë përkatëse për secilën prej institucioneve, të cilët kanë prezantuar personat e kontaktit dhe persona të detyruar përgjegjës për raportimin. Disa prej institucioneve kanë raportuar dhe nëse e konsultoni dot faqen, kanë raportuar aktivitetet. Administrata e KQZ është duke vlerësuar të gjitha rastet një për një, deri në momentin që flasim për ato që janë raportuar, nuk janë konstatuar raste të cilat mund të përbënin shkak ligjor, mbi të cilat Komisioneri do të vendoste ndalimin e zhvillimit të aktiviteteve.

Z.M.Çakaj: Më fal për ndërhyrjen, nuk e di se për një problem teknik nuk po lidhem dot nëpërmjet kompjuterit, kam hyrë në mbledhje live online me anë të telefonit dhe nuk e ndoqa nëse ishit, kur unë bëra denoncimin konkret.

Z.I.Celibashi: Unë nuk e ndoqa fare sepse pati një mbyllje të kompjuterit.

Z.M.Çakaj: Dakord më lejoni ta ripërsëris. Në datën 25 ka hyrë në fuqi, akti i miratuar nga Komisioni Rregullator, për veprimtaritë e ndaluara. Në datën 26 personalisht më ka ardhur një denoncim për një veprimtari të ndaluar, që është zhvilluar nga një deputet i Parlamentit Shqiptar dhe konkretisht, shpërndarje leje legalizimi nga ky deputet. E kam orientuar denoncuesin ta raportojë këtë shkelje në ndërfaqen e raportimit të ngritur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe personalisht pak më parë, sapo ju falenderova lidhur me ngritjen e ndërfaqes, e bërë funksionale që në momentin e parë të hyrjes në fuqi të aktit. Ndërkohë, jo më

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

larg se dje, po i njëjti deputet i mazhorancës, i Parlamentit Shqiptar, të njëjtin veprim, shpërndarjen në publik të lejeve të legalizimit e ka kryer përsëri, pra jemi në rast recidivist, rast përsëritës. Së pari është një veprimtari e ndaluar, të cilin sapo e denoncova, në respekt të aktit normativ të miratuar nga Komisioni, edhe së dyti, ajo çfarë na bën më shumë çudi në këtë rast është se çfarë pune ka deputeti me një dokument zyrtar të Shtetit Shqiptar, i cili as drejtorit të ASHK vendore nuk i takon, por ai duhet të jetë dokument zyrtar i prodhuar në zyrat e shtetit shqiptar dhe të jetë i depozituar sipas afateve të caktuara dhe nëse kemi mundësi, meqë kemi arritur në këtë ditë që të depozitohet, duhet të vijë me postë, ose në pamundësi të shpërndahen në sportel nga specialist përkatës. Si përfundon dokumenti zyrtar i shtetit në duart e deputetit. Në gjykimin tim, por besoj kjo ngelet për t'u vlerësuar dhe gjykuar dhe nga ana juaj, ky është shpërdorim i pastër detyre, o nga drejtori i ASHK vendore ose nga përgjegjësi, o nga deputeti. Kështu që unë ju ftoj ta hetoni këtë rast të përsëritur dhe sigurisht në përfundim të vlerësimit dhe hetimit objektiv të merrni masa dhe sanksione konkrete. Besoj se ky rast është denoncuar në ndërfaqen e raportimit.

Z.I.Celibashi: Po faleminderit zoti Çakaj do ta verifikojmë, por gjithësesi paraprakisht dua t'u them juve dhe për interesin e publikut dhe kujdo tjetër, që është absolutisht e ndaluar dhe për këtë nëse ka një gjë që është shumë e qartë në aktin që ka miratuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është pikërisht moslejimi i shpërndarjes së lejeve të legalizimit, apo i titujve të pronësisë në mënyrë publike dhe për qëllime elektorale. Më tepër akoma, ashtu sikurse ju e thatë dhe unë bashkohem plotësisht me konstatimet dhe me vlerësimin tuaj, shpërndarjet e lejeve të legalizimit, nuk është aspak çështje e deputetit dhe e askujt tjetër, funksionar qoftë edhe ky funksionar tjetër publik. Ajo është përgjegjësi e administratës

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

publike, të ngarkuar me lejet e legalizimit dhe është një marrëdhënie ndërmjet kësaj administrate dhe personit të interesuar. Përtej kësaj çfarë ka parashikuar ligji, çdo veprim, çdo angazhim i kujtdo tjetër është i dënueshëm nga ligji, por mendoj që edhe në pikëpamje morale është një gjë e shëmtuar. Shpresoj që qoftë thirrjen tuaj, qoftë thirrjen e institucionit të KQZ lidhur me këtë çështje, ta dëgjojë kushdo i interesuar dhe i painteresuar që të mos vazhdojë më të angazhohet në veprimtari të tilla. Edhe në pikëpamjen time personale, nuk e nderon asnjë, për ata që përfshihen në ndarjen e lejeve të legalizimit. Është një çështje që nuk është aspak meritë e askujt, por është thjesht dhe vetëm një çështje që është ndërmjet personit të interesuar dhe zyrës që vendos mbi kërkesat e legalizimit. Gjithsesi, për ta mbyllur edhe në pikëpamje formale, procedurale do ta shikojmë dhe konsiderojmë këtë akt.

Znj.H.Vukaj: Zoti Celibashi meqenëse jemi në një pikë kaq problematike për të tretët, apo për personat që iu adresohet, njëkohësisht shqetësuese për ju, për ne si organ që miratua aktin, por edhe për ju i cili jeni autoriteti zbatues i këtij akti, do të gjeja me vend një sqarim publik, në lidhje me pikën aq kruçale të atij akti që mori goxha diskutim dhe u miratua e u mirëprit, nga të gjithë anëtarët e Rregullatorit, atë të ndalimit të koncesioneve dhe të PPV-e. Jo më larg se sa sot, ose dje, një prej ministrave të kabinetit del dhe lançon publikisht, nën kamuflimin e fjalës tender, por që ato janë koncesione, sepse janë fakte apo procedura të njohura botërisht, procedura të cilat janë rishtazhi të hapura, pra janë pjesë e atij ndalimi, por që nuk janë konsideruar nga zonja Ministre e cila i ka hapur. Kështu që do ju lutesha vëmendjen tuaj edhe në këtë drejtim, nëse e vlerësoni për të nisur një hetim administrativ, në lidhje me këtë pikë materialet mediatike janë të bollshme dhe stafi juaj mund t'ua adresojë konkretisht.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Z.I.Celibashi: Padiskutim, nuk e di për çfarë rasti bëhet fjalë, do ta verifikojmë dhe pa padiskutim që do të bëjmë...

Znj.H.Vukaj: Kemi një ndalim funksionimi të internetit ndoshta.

Znj.I.Nano: Duhet të ketë një problem teknik tek Komisioneri.

Z.M.Çakaj: Duhet të ketë ndonjë lidhje kjo situatë e Covid me internetin se s'ka mundësi.

Znj.I.Nano: Të nderuar kolegë mendoni që të ndërpresim mbledhjen derisa të zgjidhet ky problem teknik, pasi me fillimin e shqyrtimit të aktit duhet të jetë i pranishëm Komisioneri për prezantimin e tij.

Z.A. Çela: Për mua ok.

Z.M.Çakaj: Po dakord jemi.

Znj.H.Vukaj: Pa problem.

Znj.I.Nano: Atëherë ndërpresim për pak minuta mbledhjen e Komisionit Rregullator derisa të zgjidhet një problem teknik dhe rikthehemi përsëri. Lutemi IT së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të na mundësojë rikthimin normal në mbledhjen e Komisionit Rregullator. Faleminderit! 5 minuta pushim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Z.I.Celibashi: Më dëgjoni tani?

Z.A.Llano (IT): Po dëgjohet, është në rregull.

Znj.H.Vukaj: Po të dëgjojmë, por kam përshtypjen që kolegët u shkëputën pak se menduan..

Z.I.Celibashi: Ju kërkoj ndjesë por nuk e di, mesa duket ka probleme me kompjuterin dhe tani jam loguar nëpërmjet Ipad-it.

Znj.H.Vukaj: Është problem i gjithanshëm por gjithsesi..


Znj.I.Nano: U rikthyem, zoti Çaka nuk është në linjë, mos gaboj. Atëherë kemi një problem Z.Dritan Çaka anëtar i Komisionit Rregullator ka disa probleme teknike me internetin. zoti Çela jeni në linjë ju?

Z.A.Çela: Po.

Znj.I.Nano: Zoti Çaka nuk merr pjesë ose ka dëshmuar vullnet për të mos marrë pjesë në mbledhje, sepse ai hyri në mbledhje, ne e verifikuam quorumin që në fillim të mbledhjes kur ishim të pranishëm 5 anëtarët e Komisionit Rregullator, kështu që kërkoj mendimin tuaj ju lutem, për vijimin e mbledhjes. Të nderuar kolegë, një mendim tuajin për vijimin e mbledhjes.

Z.M.Çakaj: Po bëjmë edhe pak pushim, marrim kontakt edhe me anëtarin tjetër të Rregullatorit të shikojmë se çfarë problemi ka.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Z.A.Çela: Edhe unë ashtu mendoj.

Znj.H.Vukaj: Nëse problemin e ka të pazgjidhshëm, atëherë do të konsiderojmë që të vazhdojmë ne të katërt, nëse problemi është në tentativë për t'u zgjidhur, po presim të na bashkohet zoti Çaka. Si mendoni?

Znj.I.Nano: Atëherë t'i japim vetes, ora është 10:45, t'i japim vetes pak më tepër kohë, nuk e di Komisioneri duke qenë..

Z.I.Celibashi: Nëse e konsideroni, unë mendoj që të lëmë një orë fikse, është 10:45, ta lëmë në 11:30 ose në 11:00.

Znj.I.Nano: Në 11:00 dhe brenda një çerek ore ne e kuptojmë nëse është një problem i zgjidhshëm dhe t'i japim kohë kolegut. Atëherë, besoj se kam edhe konsensusin e kolegëve që janë të pranishëm në mbledhje, të rilidhemi në orën 11, për të vlerësuar nëse është i zgjidhshëm problem i kolegut Çaka. Ndjesë edhe njëherë për këdo që po na ndjek në këtë moment, janë probleme teknike, kështu që rilidhemi në orën 11. Faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj.I.Nano: Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator, i nderuar Komisioner, të nderuar përfaqësues të partive politike parlamentare, vijojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator me rend dite Për rregullat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”.

Dritan Caka: Atëherë mund të bëj një ndërhyrje të vogël? Ju kërkoj të gjithëve ndjesë edhe kolegëve por edhe të gjithë atyre që mund të na dëgjojnë. Ishte dicka që ishte përtej mundësive të mia për faktin se duke qenë se marrim pjesë në mbledhje me këto platforma online, pata një problem teknik dhe u shkëputa, ndjesë dhe një herë të gjithëve.

Ilirjana Nano: Zoti Caka janë të pranueshme në këto situata. Fillojmë atëherë me shqyrtimin e projektvendimit “rregullat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”. Do të ftoja komisionerin shtetëror të zgjedhjeve të bënte një prezantim të shkurtër të projekt aktit.

Ilirian Celibashi: Atëherë projektvendimi që kemi sjellë për miratim është në kompetencë .. miratuar. Projekt akti që kemi sjellë për miratim ka reflektuar ndryshimin e fundit të kodit zgjedhor, në të cilin janë parashikuar detyrat e shtuara si për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ashtu edhe për Policinë në raport me zgjedhjet. Konkretisht në Kodin Zgjedhor parashikohet se Policia e Shtetit ushtron detyrat e veta në shërbim të zgjedhjeve me paanshmëri të plotë ndaj subjekteve zgjedhore. Gjithashtu parashikohet se veprimtaria e saj ... sipas rregullave të përcaktuara në ligj dhe në anën ligjore të miratuara nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Gjithashtu janë një grup nenesh të Kodit Zgjedhor që parashikojnë detyrat e shtuara për administratën zgjedhore dhe Policinë e Shtetit në raport me zgjedhjet, sepse është neni 34 germa H, neni 79 neni 109 6,7, neni 109 3, neni 110 2, 114 3, 115 7, 121 2. Gjithashtu ky projektvendim ka reflektuar ndryshimet e fundit në ligjin 108 2014 për Policinë e Shtetit. Projektvendimi percakton rregullat,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

detajon rolin në përgjithësi të Policisë së Shtetit dhe të Administratës Zgjedhore në raport me ndjesitë e policisë së Shtetit gjatë veprimtarisë së tyre në shërbim të zgjedhjeve. KQZ ka patur një akt më përpara. Ka qenë një akt i cili ka rregulluar aspektet e sjelljes së Policisë së Shtetit dhe të Forcave të Armatosura në zgjedhje, ka qenë në datat 23.03.2009. Mendoj se këtë akt me miratimin e aktit tuaj sot do ta shfuqizoj. Në mënyrë të përmbledhur ky projekt vendim parashikon dallimin dhe përdorimin gjatë gjithë fushatës zgjedhore të forcave komando dhe forcave të tjera të ushtrisë dhe struktura të tjera të posacme si ndalimin për përdorimin e tyre për objektet që janë të lidhur me zgjedhjet ashtu sic e parashikon Kodi Zgjedhor. Ndalimin dhe qëndrimin të personave të armatosur në mjedisin e qendrës së udhëtimit dhe raste të përjashtimit ku lejohen punonjësit e Policisë së Shtetit për të hyrë në qendrat e votimit sipas parashikimit të nenit 109 të Kodit Zgjedhor, parashikon detyrime për punonjësit e Policisë së Shtetit ngarkon me detyra në shërbim të zgjedhjeve përveç identifikimit armatimit koncentrimin në perjudhën 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve duke përcaktuar lejimin e qëndrimit të tyre në mjediset e brendshme apo të jashtme të ndërtesës që kryen administrim zgjedhor vetëm me kërkesë të komisionit zonal për administrimin të zgjedhjeve ose të komisionit të qendres së votimit. Kur vendimi parashikon gjithashtu formën dhe përmbajtjen e dokumentit të identifikimit të punonjësit të Policisë së Shtetit ngarkuar me detyra zgjedhore. Projekt akti parashikon detyrimet e Drejtorit të Policisë së Shtetit që me urdhër të vecantë të përcaktojë llojin e armatimit dhe të pajisjeve të tjera që do të mbajnë punonjësit e Policisë së Shtetit ngarkuar me detyra zgjedhorefakti që ky është një risi në akt pasi në aktin e mëparshëm të KQZ-së ishte përcaktuar..... një përcaktim në fakt nuk kishte asnjë mbështetje ligjore. Detyrimi për Policinë e Shtetit që përgatit planin e masave në funksion të ushtrimit korrekt të veprimtarisë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

e kryer si detyra në shërbim të zgjedhjeve. Ndër të tjera parashikohet instruktimi dhe trajnimi I punonjësit së Policisë së Shtetit të ngarkuara me detyra gjatë procesit zgjedhor ndalimin e angazhimit të punonjësit se Policisë së Shtetit për të përdorur dhe për të angazhuar me detyra zgjedhore të cilët janë rekrutuar vetëm 4 muaj të fundit përpara ditës së zgjedhjeve. Ka përcaktuar rregullat për komunikim bashkërendimin e masave veprimet e KZAZ-së me Policinë e Shtetit dhe përgjegjësitë e Sekretarit të KZAZ-së për dokumentimin e rasteve me detaje si në rregullat për ruajtjen nga ana e Policisë së Shtetit administrimi zgjedhor. Ka përcaktuar ky akt një regjistër të posacem në lidhje me vepra penale në fushën e zgjedhjeve, të cilat regjistri I cili I bën me dije KQZ-së e mendoj të mbajmë nga Drejtori I Përgjithshëm I Policisë së Shtetit për cdo referim që ka të bëjë me veprat unale në fushën e zgjedhjeve, e ka përcaktuar detyra në veprime për punonjësit e Policisë së Shtetit në lidhje me shoqërimin e materjaleve zgjedhore nga KZAZ në KQV dhe anasjelltas. Ka përcaktuar rregullat në lidhje me ndërhyrjen e menjëhershme të Policisë së Shtetit, rastin e krimeve të rënda që ndodhen në qendrën e votimit apo në vendet e numërimit të votave apo dhe në përgjithësi në zyrat ku kryen veprimtari zgjedhore. Së fundi ka përcaktuar dhe shkelje të sanksionit që lidhen me sanksionet që lidhen me shkeljet gjatë përmbushjes së detyrave në procesin zgjedhor nga ana e Policisë së Shtetit. Pak a shume keto ishin në mënyrë të përmbledhur cfare ky akt parashikon.

Faleminderit!

Iliriana Nano: Të nderuar kolegë nese keni ndonje diskutim ne parim lidhur me projektvendimin “Per rregullat e veprimtarise Policisë se Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”?

Nuk ka?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Përfaqesuesit e partive politike nese ka ndonje diskutim në parim lidhur me projektvendimin?

Nëse jo kalojmë në miratimin në parim të projektvendimit “Për rregullat e veprimtarisë Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve.”

Të nderuar kolegë kush është dakord në parim me projektvendimin?

5 vota pro.

Miratohet në parim projektvendimi.

Kalojmë nen për nen për shkak të volumit të projektvendimit, une nuk do të lexoj nenet një nga një, sepse akti është I njohur për anëtarët e rregullatorit, për mediat për subjektet politike. Kështu që do ta nis diskutimin nen per nen nga neni 1 dhe vetëm në rastet kur kemi propozime për shtesa, ndryshime, pyetje apo komente atëherë le t’I drejtojmë pyetje komsionerit apo do të bëjmë komente.

E nisim me nenin 1 të nderuar kolegë, nese keni komente?

Perfaqësuesi I Partise së Lëvizjes për Integrim na është bashkuar sot, keni ndonjë propozim konkret për shtesa apo ndryshim?

Mesa shoh nuk ka. Atëherë ftoj kolegët të votojmë nenin 1 sipas tekstit të paraqitur nga propozuesi.

Kush eshte dakord?

5 vota pro .

Miratorhet neni 1.

Neni 2 me titull përkufizime: përkufizohet KQZ,KQV,KZAZ, qendër votimi VNV, mjediset jashtë qendrës së votimit materjal propagantues statike dhe perjudha e angazhimit policisë ne zgjedhje.

Keni komente, ju lutem të nderuar kolegë?

Po zoti Caka?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Dritan Caka: Une kisha nje koment te neni 2 pika 6, është përkufizimi I mjedisit jashtë qendrës së votimit dhe është vendosur një perimter me një rreze prej 150 metrash nga qendra e votimit. Kjo është më shumë dhe një pyetje e pjesës sqaruese për komisionerin. Unë mendoj që 150 metra në një diameter prej 300 metra mund të jetë shumë e madhe dhe mund të krijoj dhe probleme, sepse shuma në qendra votimi mund të jenë dhe buzë rruges dhe nje distance e tille mendoj se është shumë e madhe për më tepër ishte dhe pyetje ky 150 metra si është vleresuar nga ana e strukturës admnistratës së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për të arritur në këtë përfundim? Unë personalisht mendoj se është një distancë e madhe.

Ilirian Celibashi: Konstatimi që beri zoti Caka është korrekt. Në fakt idea e kufizimit për 150 metra ka të bëjë me rastin kur është e mundur Brenda territorit të pronës ku është e vendosur qendra e votimit, sepse nuk do të kishte sens që shtrirja te bëhej në pronën e dikujt tjetër. Ne nuk kemi pse vendosim kufizime, ne vendosim kufizime vetem për teritorin e pronës ose dobitë ku është e vendosur qendra e votimit. Dhe në rastin kur kjo është e mundur do të shkojë jo më pak se 150 metra por në rast se kjo nuk është e mundur, mendoj se është llogjike që ne nuk mund të shkojmë te shtëpia e tjetrit të vendosim kufizime.

Muharrem Cakaj: Me fal nje sqarim dhe per kolegun. Koncepti I perimetrit per 150 metra është sanksionuar në fakt dhe në Kodin Zgjedhor, në nenin 101 pika 1 germa B, ka lidhje me materjalet propagandistike, pra KQV-ja ne drejtimin e Kryetarit dhe Sekretarit dhe në praninë vezhguese një orë përpara hapjes së votimit nder detyrat e tjera ka si detyrë në pikën B të heqë dhe materjalet propogandistike që mund të ndodhin në një qendër votimi në një rreze prej 150 metra pra koncepti 150 metra përfshin hapësiren jashtë qendrave të votimit dhe unë personalisht bie dakord me vlerësimin dhe konstatimin e komisionerit që për aq sa është e mundur

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

pasi morën të drejtën e pronësisë së tjetrit, por si koncept e kemi përfshirë në Kodin Zgjedhor kështu që besoj të njëjtën standart duhet të mbajmë.

Iliriana Nano: Po zoti Cakaj të mos harrojmë që referenca prej 150 metrash përmendet edhe më tej në projektvendim ku ndalohej prania dhe grumbullim i personave në një rreze prej 150 metra. Kështu që prania e personave në një rreze 150 metra nga qendra e votimit do të mund të ndalonte edhe qarkullimin e lire të njerëzve kështu që është e mundur ndërmjet administratës të bëjmë një saktësim.

Dritan Caka: Te pjesa materiale propogandistike te pika tjetër absolutisht që po.

Ilirjana Nano: Te pika tjetër është ok sepse është e parashikuar.

Helga Vukaj: Në fakt ambientet e jashtme duhen ta kenë këtë rreze perimetrike, pasi e dimë shumë mirë se çfarë ka ndodhur në procese zgjedhore dhe është shfrytëzuar për keq kjo rreze perimetrike.

Madje dhe trotuaret janë shfrytëzuar për keq, por në këtë rast komisioneri është treguar I kujdesshëm dhe ka parashikuar e ka sqaruar apo saktësuar atë që nuk ka prirjen me këtë akt të prekë pronën e personave të tretë apo të çënojë posedimet e lira të tyre. Rrezja perimetrike padyshim që vjen nga baza ligjore që kolegu Cakaj citoi më lart dhe ka një standart në momentin kur ne ndalojmë propogandimin në këtë rreze.

Atëherë në sensin e propagandimit merret për bazë edhe në kuadrin e sigurisë si rreth sigurie të ndikimit njerëzor. Kështu që unë absolutisht e gjej me vend propozimin që ka bërë komisioneri dhe do t'i qëndroja deri në fund këtij propozimi, pasi e shikoj të rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit. Për më tepër ky është një akt i cili dedikohet dhe duhet të duatrokitet pasi çel siparin e një veprimtarie të pandodhur më parë, e cila i jep një rol proaktiv Policisë së Shtetit për t'u përfshirë në procesin zgjedhor, pikërisht në meritë jo vetëm të rendit të sigurisë por dhe të pacënushmërisë apo ndikimit me votën e lirë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Faleminderit!

Iirjana Nano: Faleminderit, zonja Vukaj. Edhe unë bashkohem me mendimin e kolegëve që kërkon të adresojë një shqetësim, por duke e vendosur tek përkufizimet mendoj që na krijon problem, pra të mos harrojmë: 1 kemi ndalimin më tej të materialeve propagandistike dhe kjo është e parashikuar shprehimisht në Kod. Bie 100% dakord me kolegun Cakaj që ndalimi I vendosjes së materialeve te tilla në rrezen 150 metra është i parashikuar, por kemi dhe një dispozitë tjetër që ndalon praninë dhe grumbullimin. Grumbullimi është njëra anë, prania e njerëzve të ndalohet në një rreze 150 metra kur ka një rrugë që kalon ku një diameter 300 metra përfshin gjysmën e një fshati ku mund të ndodhet një qendër votimi. Kështu që prania e njerëzve, nëse e lemë këtu dhe më tej e korrigojmë “te prania e njerëzve”, do t’ju lutesha ta shohim me kujdes, nuk mund të ndalojmë praninë e njerëzve. Prania është dhe një kalim i rastësishëm në një rrugë në këtë rreze, 150 metra. Është ushtrimi i te drejtave brenda sikur tha dhe komisioneri drejtave të pronësisë apo të përdorimit të një objekti tjetër pikërisht në rreze prej 150 metrash. Pra e vetmja .. sanksionohet drejt përdrejt në Kod është ndalimi I vendosjes materjaleve propogandistike në këtë rreze.

Helga Vukaj: Por për sa kushtet e diktojnë zonja Nano dhe kërkohet një garanci e shtuar për zgjedhje të paprekshme të pandikuara, të pashantazuara dhe të pa cënuara, në këtë rast mendoj që 150 metershi është domosdoshmëri për ta etiketuar dhe për ta futur këtu si përmbajtje në këtë pikë ku sqarohen të gjithë përkufizimet se cdo të thotë 150 metra dhe cdo të thotë ambient I jashtëm apo mjedise jashtë qendrës së votimit. Nuk cenohet as të preket pronësia askujt, as të cenohet posedimi I lirë I tij dhe as të cenohen njerëzit që ecin si kalimtarë në rrugë. Por të mos ndodhin precedentet e së kaluarës të cilët janë kthyer në makth për interesin publik.

*Zbardhi materialin e incizuar
Valbona Dushi*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Dritan Caka: Jam dakort ama në 150 metra është një distancë shumë e madhe, është një distance, e cila mund të shkoj përtej edhe disa ndërtesave njëkohësisht pra dhe në qoftëse do të marrim një distancë të një pallati është përtej pra më shumë I bie që të kufizohet edhe një grumbullim..

Helga Vukaj: Nuk kufizohet aspak zoti Caka, por duhet të ndërgjegjësojme të gjithë publikun që ... duhet të jenë të paprekura dhe të mos ketë asnjë tentacion për të vepruar ndryshe.

Iirjana Nano: Zonja Vukaj, jemi te perkufizimet, në fakt pa shkuar te ndalimi.

Dritan Caka: Në cdo rast ne mund t'I vendosim ku janë materialet propogandistike..

Helga Vukaj: Thelbi fillon nga perkufizimi..

Dritan Caka: Unë mendoj se 150 metra është jashtezakonisht shumë.

Helga Vukaj: Do te doja të pyesja zotin Celibashi cilës dispozite I është referuar për këtë pikë?

Dritan Caka: Nuk është e nevojshme të bëjmë një nomim kaq të madh.

Helga Vukaj: Këtë e kemi një atribut të padiskuteshem ne si rregullator për të detajtuar situaten.

Dritan Caka: Pikërisht ne e detajojme por duhet të marrim parasysh edhe disa rrethana shume objektive.

Helga Vukaj: Të gjitha këto rrethana I kemi marrë parasysh, zgjedhjet e kontestuara dosje penale në prokurori e kështu me rradhë të gjitha këto rrethana janë marrë në konsideratë. Kështu që do të doja të degjoja zotin Celibashi..

Dritan Caka: Një qendër fshati ku ndodhet qendra e votimit të thoni 300 metra një rreze 300 metra I bie në të gjithë...

Helga Vukaj: Jo ne themi një rreze 150 metra. Do të preferoj një prononcim të zotit Celibashi se ku është bazuar.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Muharrem Cakaj: Kolegë, një sqarim të shkurtër së pari në gjykimin tim personal besoj të gjithë biem dakord për këtë përkufizim është I qarte shterues dhe sigurisht ka edhe rastin e përjashtimit pra së pari koncepti 150 metra buron nga Kodi Zgjedhor sic e sqarum dhe pak më parë dhe për sa kohë palët kanë vendosur kanë dakortësuar që në një rreze 150 metra mos të lejojnë materialet propagandistike për arsye se mund të ndikojë apo mund të ushtrojë një ndikim të padrejtë në favor apo disfavor të një projekti. Atëherë si mund të lejojmë në grumbullimin e personave në mënyrë që të intimidojë zgjedhësit pra ne heqim nga njëra anë materialet propagandistike në mënyrë që vizualisht mos të intimidojnë votuesit nga ana tjetër do të lejojmë grumbullimin e personave.

E parë kjo edhe në përkufizimin e parashtruar për shqyrtim dhe miratim nga ana jonë dhe përkufizimin e draftin e parashtruar nga komisioneri. Unë e gjej shumë korrekt për arsye se së pari është futur nocioni I shenjave dalluese dhe së dyti është futur koncepti I moscënimit të interesit të ligjshëm të pronësise së një tjetri. Kështu që në këtë kontekst, unë mendoj se është I qartë i kap të gjithë elementet e duhur ky nocion ky përkufizim dhe qëllimi edhe nga ligjvënësi është mëse I qartë mos lejimin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm të votuesit ndalimin e intimidimit të votuesit.

Ilirijana Nano: Po zoti Cakaj faleminderit.

Unë do t'ju jap vetëm një shembull, qendra ku unë votoj si shtetase ndodhet në një shkollë, në një ambient në një godinë që ndodhet ngjitur me pallatin tim të banimit. Si do ta perimetrioni me shenjat dalluese edhe pallatin ku une banoj? Kjo është ideja që 150 metra nuk mund ta vendosesh në shenja dalluese.

Muharrem Cakaj: Përkufizimi për sa kohë në draft është shtuar pa cënuar interesi me ligj në pronësi të të tremeve, unë mendoj se është I qartë, është I përjashtuar pronësia e të tremeve nuk cënohet interesi I ligjshëm për sa kohë është e mundur

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

dhe qëllimi nuk është ky që të përkufizojmë 50 apo 100 apo 150 meter, qëllimi është që Policia e Shtetit sic jemi të gjithë dakord duke qenë se ka marrë rol nga neutral rol proaktiv tani në zgjedhje I ka pasur ligjvënës t'I japë një rol më aktiv ta përfshijë t'I thojë që hajde këtu e ti I nderuar Polici e Shtetit ti ke 1 2 3 4 5 detyra konkrete.

Ti do të ruash rend do të garantosh rendin dhe sigurinë dhe ti do te garantosh zgjedhjet të qeta dhe të pandikuara nga asnjë por jo vetem brenda në qendren e votimit, por edhe jashtë qendres se votimit dhe koncepti I perimetrit se mund të conim dhe një rreze apo perimeter tjetër ndërkohë që perimetri tjetër I referuar Kodit Zgjedhor është kjo 150 metra. Dhe analogjia unë e gjej me shumë vend këtu konceptin e parashikuar në Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër dhe merakun I juaj është I pasqyruar ne këtë përkufizim pasi nuk cenohet interesi I ligjshmerise të palëve të treta dhe gjithashtu është parashikuar në përkufizim por edhe nenin 14 më pas që do te kalojmë te mjediset e tjera të qendres se votimit është parashikuar dhe shenjimi me shenjat dalluese I perimetrit në rezen 150 metra.

Ilirjana Nano: Do ta rimarrim kur te shohim dy ndalimet, më tej sigurisht në përkufizim është përjashtuar cënimi I pronësise atë që u diskutua dhe nga ana ime dhe nga ana e zonjes Vukaj.

Kështu që kur të rikthehem te dy dispozitat e tjera që parashikojnë 150 metërshin një që e kemi parashikuar ne Kodin Zgjedhor dhe një tjetër që e parashikojmë ne, i rikthehem të njejtin diskutim.

Kështu unë do të ftoja kolegët te kalojmë në votim për nenin 2.

Kush është dakord te nderuar kolege?

5 vota Pro.

Miratohet neni 2 I projektvendimit.

Kalojmë në nenin 3 janë parime të pergjithshme.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Keni ndonje diskutim lidhur me parimet e përgjithshme, ndonjë propozim për shtesa apo ndryshim?

Mesa shoh nuk kemi.

Kalojmë për votim nenin 3.

Kush është dakord për nenin 3 sipas përmbajtjes se paraqitur.

5 vota Pro.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4 “Ndalimi I përdorimit të forcave dhe strukturave të posacme”. Personalisht kam një propozim duke qene që ky nen, është referuar nenin 5 të Kodit Zgjedhor. Në nenin 5 parashikohen dhe forcat komando, pra ketu janë parashikuar forcat e policise kriminale dhe forcat e tjera të ushtrisë në fakt neni 5 I Kodit Zgjedhor thotë forcat komando dhe forca të tjera të ushtrisë ndalohen që të përdoren gjatë fushatës zgjedhore kështu që unë personalisht kam propozimin të shtojmë “dhe forcat komando”. Kolegë të tjerë kanë ndonjë propozim?

Po zonja Vukaj?

Helga Vukaj: Po t’I referohemi pikes 1 këtu citohet apo mund ta lexoj : ndalohet përdorimi I policise kriminale dhe forcave të tjera të ushtrisë gjatë gjithë fushatës zgjedhore.

Në fakt do të doja të specifikoja dhe të shtoja si propozim. Ju sapo e thatë”forcat komando” unë do të doja të shtoja “forcat shigjetash, shqiponja, RENEA dhe FNSH” Për arsyen e thjeshtë sepse këto janë forca të cilat për hir të veprimtarisë së tyre meritojnë të jenë forca të targetuara për të mos u perdorur jo vetëm për hir të veprimtarisë së tyre policore e cila nuk është një veprimtari normale dhe nuk konsiderohet se ndërhyt në situatë normale dhe për sa kohë nuk kemi çështje të terrorit, aty nuk ka gjasa që të ndërhyet por edhe në kuadër të pabesueshmërisë së

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

publikut e cila tashmë është e provuar dhe botërisht për mosbesimin te këto forca shigjetash shqiptonja komando RENE A FNSH etj.

Është e kahershme situata me këto forca të cilat jo vetem kanë demonstruar sjelljen në menyrë jo profesionale por janë targetuar dhe etiketuar me një bum të madh mediatik si forca të përdorura në mënyrë të njëanshme dhe si forca të cilat kanë jo vetëm pabesueshmëri të publikut por që kanë arritur deri në marrje jetësh apo në ushtrim dhune në recitivizem të katerciptë dhe kanë arritur deri atje saqë të kemi reagim të popullsisë në masë dhe për hir të tyre të kërkohet edhe dorëheqja e Ministrisë të Brendshme.

Në këtë argument, unë mendoj që pabesueshmërisë duhet t'i jepet rëndësia e duhur sepse është pabesueshmëri jo e nje personi apo e nje grupi te caktuar interesi por e publikut mbare, duhet t'i jepet rëndësi e duhur dhe ne t'i përfshijmë. Në këtë pikë këto forca të cilat nuk mund të ushtrojnë terror apo ndoshta larg qoftë të marrin në kushtet e aprofesionalizmit apo të ndikimit partiak të marrin ndonjë veprim të diktuar, I cili mund të kushtojë dhe jetë ditën e zgjedhjeve.

Ndaj pas fjalës "I policise kriminale" ashtu sic përmendet ju forcat komando do të doja te shtoja "shigjeta shqiptonja RENE A dhe FNSH".

Faleminderit!

Iirjana Nano: Jemi në një propozim nga ana ime dhe nje propozim nga zonja Vukaj. Propozimi im bazohej te neni 5 I Kodit Zgjedhor për të shtuar "forcat komando", propozimi I zonjës Vukaj ishte per t'u shtuar "forcat shqiptonja shigjeta FNSH dhe RENE A".

Po zoti Caka?

Dritan Caka: Duke qenë se jemi në vazhdën e diskutimit te nenit 4, unë do të kisha një merak më shume te pika 2 e ketij neni është thënë të gjitha këto veprime që do të bëjmë forcat speciale duhet që në kohë reale t'i komunikojnë Komisionit

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Qendror të Zgjedhjeve dhe është thënë që në pikën e fundit duhen bërë, duhet ruajtur sekretin profesional mos të ketë një komunikim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pavarësisht se Komisioni Qendror I Zgjedhjeve në mënyrë individuale drejtohet nga komisioneri, por më mirë të ishte në kohë reale pranë komisionerit shtetëror dhe të kishte një komunikim nuk e di si mund të zgjidhej që në këto raste të ishte një komunikim i drejtpërdrejt dhe pa dashur të bëjë një lloj analize të mos kishte një kalim normal si një procedurë standarte ky komunikim duke qenë se mund të ketë edhe veprime operacionale për pjesën e sekretit.

Pra mos të kalohen procedurat e standartit që ka dhe një insitucion në pjesën administrative, të kjo pikë prandaj kam një merak.

Të gjendet që të jetënje pikë që të jetë më e afert, ndërsa të pika 3 unë mendoj që kufizimi i angazhimit të punonjësve të policisë së rekrutuar në 4 muajt e fundit para ditës së zgjedhjeve. Unë nuk arrij ta kuptoj se ku është gjetur si referencë dhe unë atë që unë mendoj është se kjo mos është një diskriminim për ata persona të cilët në 4 muajt e fundit janë angazhuar në Policinë e Shtetit.

Nuk mund të bëjmë çfarë do lloj paragjykimi dhe unë mendoj se dhe roli dhe funksioni i Policisë së Shtetit dhe strukturave përkatëse nuk duhet që të anatemohet për mungesën e profesionalizmit absolutisht që mund të ketë raste sporadige por nuk mundet që të përgjegjesohen të gjithë punonjësit e policisë në çdo strukturën e saj apo aq më tepër forcat e ndërhyrjes së shpejtë trupat RENEA apo të tjerë.

Unë në dijeninë time nuk është se kam pasur informacione në zgjedhje të mëparshme të paktën nga media për problematika të shfaqura në këto forca policore, mendoj që në këto zgjedhje dhe roli i Policisë së Shtetit është një rol më aktiv se në zgjedhjet e tjera dhe kjo ka qenë pjesë e cila është futur edhe në Kodin Zgjedhor dhe është kërkuar dhe në pale të caktuar që t'u rritet roli dhe prezenca e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Policisë së Shtetit rreth ambjenteve ku janë qendrat e votimit dhe të bëjmë kufizimet pastaj t'I shtojmë kufizimet ku vet Kodi Zgjedhor dhe mbi bazën e propozimeve të paktën nga mediat që është dëgjuar dhe të partive politike kryesisht të opozitës. Gjykoj që është shumë e zgjeruar dhe jo në përputhje me atë çfarë ligjvënësi ka dashur që në këto zgjedhje të reklamojë në lidhje me Policinë e Shtetit.

Ilirian Celibashi: Duke dhënë një sqarim në lidhje me pyetjen që bëri zoti Caka, mbi ndalimin angazhimin të punonjësit së policisë së rekrutuar në 4 muajt e fundit përpara ditës së zgjedhjeve. Kjo nuk lidhet të pakten në vleresimin tim aspak me ceshtje besueshmerie, por lidhet me ceshtje profesionalizmi. Meqënëse detyrat e Policisë së Shtetit për zgjedhjet janë disa detyra krejt specifike edhe pse në kuadër të detyrave që ka Policia e Shtetit, është menduar që në lidhje me detyrat zgjedhore të jetë ajo pjesë e strukturës së policisë që ka një lloj eksperience dhe përvojë në lidhje me këto ceshtje dhe nuk është ceshtje besimi që ata që janë të rinj janë të pabesueshem është ceshtje e profesionlizmi te experiences.

Edhe pse duket që përgjithesisht ata të cilët punonjës policie që anagazhohen me procese zgjedhore kanë nje lloj experience dhe e dyta ndalimi lidhet më tepër me një proces I cili fillon edhe mbaron në këtë perjudhë 4 mujore, nuk flasim per rastin kur themi Policia e Shtetit ka nje process rekrutimi që ka nisur me perpara.

Jemi perpjekur që të bëjmë një analogji dhe kemi gjetur bazën ligjore të këtij rregullimi dhe I gjithë korpusi I Kodit Zgjedhor që përcakton sjelljen e institucioneve publike në raport me zgjedhjet në perjudhen 4 muaj përpara dates se zgjedhjeve.

Kemi folur në aktin për veprimtari të ndaluara për përdorimin e keqpërdorimin e asetëve dhe procedurave njerëzore, në institucionet publike në lidhje me angazhimin e administrates ndryshimin e strukturave Zgjedhore e të tjera si

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

këto. Dhe në një lloj mënyre duke qenë se dhe policia është një organizatë nuk është një shërbim ushtarak por është një organizatë e cila ka për qëllim mbajtjen dhe sigurinë publike, kemi menduar që shkon dhe për rastin e policisë.

Muharrem Cakaj: Lidhur me propozimet tuaja për nenin 4 se pari e gjej me vend propozimin e zonjes Nano, për transpozimin korrekt sic parashikon dhe Kodi Zgjedhor, pra përfshirjen dhe të forcave komando në kuadrin të ndalimit të përdorimit të forcave të strukturave të posaçme, si dhe sigurisht mbështes propozimin e zonjes Vukaj për ndalimin e përdorimit të forcave shigjeta shqiponja RENE, konkretisht e lidh dhe me pikën 2 të nenit 4 kur kemi përjashtim nga situata e përgjithshme pra përjashtim nga rregulli I përgjithshëm dhe më konkretisht në pikën 2 parashikohet në rastet kur del e domosdoshme aktivizimi I forcave speciale struktura përgjegjëse duhet të njoftoj me shkrim dhe në kohë reale pranë Komisionit Qendror I Zgjedhjeve të gjithë aktivitetin objektin e punës kush e ka kërkuar dhe të tjera me radhë.

Propozimi I zonjës Vukaj ka të bëjë pikërisht me mospërfshirjen e këtyre forcave speciale, sepse këto forca speciale janë, por janë organizime speciale. Brenda strukturës së policisë sic janë repartet Shigjeta, Shqiponja RENE, dhe sigurisht ato në gjykimin tonë duhet të ndalohen, përdorimi I tyre për zgjedhjet dhe përjashtimisht në rast se ato kur të dalin të nevojshme aktivizimi I tyre atëherë ato duhet të raportojnë pranë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kështu që unë mbështes dy propozimet dhe atë të zonjës Nano dhe atë të zonjës Vukaj lidhur me ndryshimin e pikës 1 të nenit 4.

Ilirjana Nano: Po zonja Vukaj!

Helga Vukaj: Të krijojmë mundësinë e kalimit një here të pikës sonë propozuese apo të pikës 1 të nenit 4 e më pas të vijojmë, sepse dhe për publikun nuk do të ishte

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

e qartë se cilin propozim kemi në rend me qëllim që edhe propozimeve të tjera të kolegëve t’I japim kohën e duhur.

Gjithashtu do te shtoja që me të drejtë e gjeta dhe propozimin tuaj dhe ju bashkova “pas forcave komando duke etiketuar në mënyrë të nominuar shigjeta Shqiponja RENEA dhe FNSH”, pasi u referova titullit I cili thotë ndalimi I përdorimit të forcave të posatshme. Duke qenë se keto janë forca apo struktura të posacme atëherë automatikisht këto duhen ndaluar.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zonja Iliriana Nano: Faleminderit zonja Vukaj; personalisht do të isha më e rezervuar për të etiketuar struktura të caktuara të policisë; ndalimet në këtë rast burojnë nga objekti i punës së tyre dhe unë dua të bëjmë një përmbledhje të propozimeve.

Propozimi i parë ka të bëjë me përfshirjen e forcave komando të ndalimit, pra tek pika e parë e këtij neni, sikundër neni në kodin zgjedhor e ka.

Propozimi i dytë është i juaji, zonja Vukaj, për të përfshirë në këtë ndalim forcat *Shqiponja, Shigjeta, RENE* dhe *FNSH*.

Propozimi i tretë është i zotit Çaka për të vendosur komunikimin e drejtpërdrejtë me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe jo me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, në rastet e raportimit.

Dhe besoj këtu jemi me tre propozime për këtë nen. Zoti Çaka për komentimin e fundit që ju bëtë lidhur me katër mujorin, ... pra forcat që janë rekrutuar katër muajt e fundi, ... keni propozim konkret që të fillojmë votimet për propozimet.

Zoti Dritan Çaka: Për sa i përket kësaj pike duke pasur parasysh edhe sqarimin e Komisionerit, duke qenë se kjo lidhet edhe me një farë eksperience të këtyre forcave, tërhiqem nga ajo çfarë unë kisha propozuar më parë.

Zonja Iliriana Nano: Dakord! Atëherë kemi tre propozime.

Propozimi i parë në pikën 1 të nenit 4, të shtohet togfjalëshi “forcat komando” ndalohet përdorimi i forcave komando, policisë kriminale dhe vijojmë me të tjerët ...

Kush është dakord me këtë propozim ju lutem?

Paneli: Me zë dhe me dorë shprehen “dakord”.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Aleksandër Prenga*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zonja Iliriana Nano: Me pesë vota pro, miratohet.

Kemi propozimin e dytë: shtimin e togfjalëshit “forcat shqiptonja, shigjeta, RENEA dhe FNSH” pas fjalës “policisë kriminale”; zonja Vukaj jam e saktë me propozimin tuaj?

Zonja Helga Vukaj: Po, e saktë jeni!

Zonja Iliriana Nano: Atëherë kush është dakord me propozimin e zonjës Vukaj?

Kundër?

Nuk miratohet! Me dy vota pro dhe tre kundër!

Kalojmë tek propozimi i zotit Çaka! në pikën 2 të nenit 4, në rastet kur del e domosdoshme aktivizimi i forcave speciale, struktura përgjegjëse duhet të njoftoje me shkrim dhe në kohë reale pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pra zëvendësimi i Komisionit me Komisionerin.

Kush është dakord?

Kundër?

Nuk miratohet edhe ky propozim! Me dy vota pro dhe tre kundër!

Atëherë në nenin 4 u bë vetëm një ndryshim.

Kalojmë në nenin 5. Veshja dhe armatimi i policisë së shtetit!

Të nderuar kolegë nëse ka ndonjë ndërhyrje, ...!

Zonja Helga Vukaj: Më falni zonja Nano!

Zonja Ilirjana Nano: Po zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Aleksandër Prenga*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zonja Helga Vukaj: Në pikën 6 të nenit 4 unë kam një propozim ku përveç strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror kërkoj të përfshihet edhe shërbimi i kontrollit të brendshëm në MB, shërbimi informativ i ushtrisë, si dhe shërbimi i kontrollit të brendshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë. Siç dihet janë shërbime me efekt dhe me po të njëjtin rol deri diku si SHISH-i.

Zonja Ilirjana Nano: Duke saktësuar emërtimin e këtyre strukturave nga ana e administratës, ju ftoj të votojmë propozimin e zonjës Vukaj!

Kush është dakord?

Kundër?

Nuk miratohet edhe ky propozim! Me dy vota pro dhe tre kundër!

Kalojmë në nenin pasardhës “Veshja dhe armatimi i policisë së shtetit”!


Kemi ndonjë propozim konkret ju lutem për shtesa apo ndryshime?

Po zonja Vukaj?!

Zonja Helga Vukaj: Në pikën 2 të nenit 5, duhet të kemi parasysh ndarjen në dy kategori të punonjësve të policisë që bëhen pro aktivë gjatë procesit zgjedhor, që zgjat 4 muaj dhe jo vetëm ditën e zgjedhjeve; kemi ata që përfshihen në procesin zgjedhor në veprimtari rutinë por edhe ata që përfshihen me detyrë ruajtjen e KZV-ve, KZAV-ve dhe VNV-ve. Kështu që në pikën 2 mendoj të shtojmë “Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit përcakton me urdhër të veçantë llojin e armatimit dhe të pajisjeve që do të mbajnë punonjësit e policisë së shtetit të ngarkuar me detyra për mbarëvajtje të procesit zgjedhor dhe ato të ruajtjes së KZAV-ve dhe VNV-ve”. Pra ajo që shtoj është “për procesin zgjedhor dhe ato për ...”

Zonja Ilirjana Nano: Propozim tjetër ju lutem?! Nuk ka!!!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Aleksandër Prenga*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zoti Muharrem Çakaj: Ta sqarojmë pak më shumë edhe për kolegët edhe për palët e treta të interesuara, ..! Duke qenë se roli i ri i policisë, i pasqyruar edhe në kod, rezulton që policia e shtetit ka detyra edhe për periudhën përpara ditës së zgjedhjeve por është e ngarkuar me detyra edhe për ruajtjen e KZAV-ve dhe VNV-ve. Kjo ka qenë detyrë edhe e mëparshme e policisë. Ajo që është risi janë detyrat e reja që ngarkon kodi por edhe akti normativ që ne po votojmë. Kështu e gjej me vend dhe në përputhje me natyrën e aktit që ne po miratojmë propozimin e zonjës Vukaj.

Zonja Ilirjana Nano: Dakord! Faleminderit zoti Çakaj!

Atëherë votojmë propozimin e zonjës Vukaj!

Shtesa është “për procesin zgjedhor dhe ato për ...”

Kush është dakord?

“Tre vota pro dy kundër” nuk miratohet propozimi i zonjës Vukaj.

Zonja Helga Vukaj: Kishim shumicën zonja Nano! Tre vota përbejnë shumicë!

Zonja Ilirjana Nano: Jemi në kushtet e një interpretimi për ...!!!

Zonja Helga Vukaj: Entin e kemi krijuar! Nëse do ta interpretojmë!

Zonja Ilirjana Nano: Unë personalisht u shpreha dakord duke pasur parasysh që detyrat e policisë janë për katër muaj edhe më shumë dhe në këtë rast kur drejtori i policisë të nxjerrë një urdhër që të përcaktojë veshjen dhe armatimet, sigurisht në zbatim të detyrave ...! në dijeninë dhe në kujtesën time nuk kemi vendosur një precedent të tillë.

Zoti Muharrem Çakaj: Në fakt, neni përkatës do të marrë fatin e të gjithë aktit. Nëse akti kërkon shumicë të cilësuar, në gjykimin tim edhe pikat e nenet përkatëse

*Zbardhi materialin e inçizuar
Aleksandër Prenga*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

pra elementet përbërës të aktit do të duhet të miratohen me kuorumin e nevojshëm, siç kërkon edhe vetë akti. Besoj do të duhet 4 me 1.

Zonja Ilirjana Nano: Faleminderit! Më lejoni të kërkoj votimin e

Zoti Dritan Çaka: Kemi pasur precedent. Në një akt të mëparshëm propozimi im është votuar 3 me 2 dhe ai është rrezuar.

Zonja Helga Vukaj: Në varësi të llojit të aktit pra!

Zonja Ilirjana Nano: Në kushtet kur jemi 3 vota pro dy kundër, propozimi nuk miratohet.

Atëherë votojmë nenin 5 sipas përmbajtjes së paraqitur!

Kush është dakord?

Kundër?

Me katër vota pro 1 kundër, neni 5 miratohet me përmbajtjen që ishte paraqitur.

Vijojmë me nenin 6 vendqëndrimi i policisë së shtetit. Kolegë, nëse keni komente?!

Zoti Dritan Çaka: Kam vetëm një koment tek pika 1, thuhet: "... punonjësit e policisë së shtetit që ngarkohen me detyra gjatë periudhës zgjedhore respektojnë lëvizjet ..." unë mendoj që termi "periudhë zgjedhore" të zëvendësohet me termin "fushatë zgjedhore".

Zonja Ilirjana Nano: Duke pasur parasysh që kodi në neni e tij përfshin vetëm një muaj sasi kohore, mendoni se do të ishte më mirë vendosja e termit "fushatë"! mbetet pa mbuluar thoni ju!

Kolegë, keni ndonjë koment për këtë saktësim!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Aleksandër Prenga*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zonja Helga Vukaj: Për sa kohë ne kemi supozuar rolin pro aktiv të policisë së shtetit për periudhën zgjedhore,. Atëherë ku kufizim i zotit Çaka nuk më duket me vend!


Zonja Ilirjana Nano: Në akt kemi të përcaktuar dy momente: një “gjatë zgjedhjeve” dy “gjatë periudhës zgjedhore” kjo e dyta është 15 Prill – 15 Maj; do të thotë na mbetet 15 Mars – 15 Prill i pa mbuluar. Kështu që nëse saktësohet “gjatë zgjedhjeve, dhe gjatë fushatës zgjedhore”, ... mua do të dukej korrekt! Dhe do të ishte më e saktësuar. Megjithatë nëse kolegët kanë diskutime të tjera shtesë, ...

Po zoti Çakaj!

Zoti Muharrem Çakaj: Për të qenë korrekt, në nenin 8 të Kodit Zgjedhor parashikohet periudha zgjedhore dhe jam dakord edhe me përkufizimin që i ka dhënë kodi zgjedhor por edhe me përkufizimin që dha zoti Çaka. Por kam përshtypjen që në draftin e paraqitur do të duhej sqaruar lidhur me rolin dhe detyrat e policisë përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore. Propozimi im konkret është që ndryshimi në këtë nen të jetë “roli dhe detyrat e policisë përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore”. Ne, në këtë akt, po ngarkojmë policinë e shtetit me një sërë detyrash dhe po përcaktojmë rregullat e sjelljes dhe funksionimit të policisë së shtetit në raport me zgjedhjet për periudhën 4 muaj përpara deri në datën e zgjedhjeve; kështu që fjala korrekte në gjykimin tim personal do të ishte “roli dhe detyrat e policisë përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore”.

Zonja Ilirjana Nano: Të bëj një pyetje se si do të aplikohet ky akt; nëse unë do të pyes çfarë bën nesër policia e shtetit? Meqë jemi edhe para fushatës zgjedhore!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Aleksandër Prenga*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zoti Muharrem Çakaj: Gjithë detyrat që i kemi caktuar me këtë akt. Duke filluar nga momenti që krijohet KZAZ-ja, nga ruajtja e selisë së KZAZ-së, detyra të tjera të ngarkuara, pra të gjitha detyrat që ne do ti miratojmë asaj me këtë akt!

Të gjitha institucionet e ngarkuara nga kodi zgjedhor dhe nga ligji janë të detyruara që të zbatojnë rregullat e miratuara nga kodi apo me aktet tona.

Siç përmenda shembullin e KZAZ-ve, ka edhe shembuj të tjerë plot. Siç e dimë, nuk fillon manipulimi ditën e votimit, në thonjëza e them këtë, as një javë përpara, fillon muaj e muaj përpara.

Kështu që, në rastin konkret, i kemi dhënë policisë së shtetit të drejtën të marri rolin dhe detyrat e posaçme të ngarkuara edhe nga ky akt për të evidentuar edhe këto raste të shkeljeve.

Faleminderit!

Zonja Ilirjana Nano: Faleminderit! Unë kisha një pyetje për zonjën Tenolli, nëse e kam në linjë?

Atëherë pyetja për zonjën Tenolli është: Ku është bazuar hartimi i nenit 6 të projektvendimit “Vendqëndrimi i policisë së shtetit”

Zonja Tenolli: Tek neni përkatës i Kodit Zgjedhor që përcakton ndalimet gjatë, ...

Zonja Ilirjana Nano: Cili është neni ju lutem?!

Zonja Tenolli: Një sekondë, ju lutem!

Neni 5 i Kodit Zgjedhor! D.m.th. janë të gjithë ndalimet dhe për të siguruar në maksimum, qoftë edhe dukjen vizuale të forcave të policisë së shtetit, gjatë ditës së zgjedhjeve sepse aty është edhe fokusi kryesor zgjedhor, për të siguruar qetësinë dhe shprehjen në mënyrë të rregullt të procesit të votimit, ... prandaj është

*Zbardhi materialin e inçizuar
Aleksandër Prenga*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

përcaktuar që të qëndrojnë në vendet e përcaktuara në këtë akt dhe aktet e tjera nënligjorë të nxjerra nga KQZ-ja.

Zonja Ilirjana Nano: Pra në nenin 5 të Kodit Zgjedhor!

Zonja Tenolli: Po!

Zonja Ilirjana Nano: Dakord, faleminderit!

Kjo nuk ka lidhje me periudhën 4-mujore, sepse ndalimet janë gjatë gjithë fushatës zgjedhore, thënë me fjalë të tjera.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Aleksandër Prenga*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj.I.Nano: Atëhere, le të bëjmë një përmbledhje kemi dy propozime, deri tani. Propozimi i parë është propozimi i zotit Çaka, i cili kërkoi që togfjalëshi “gjatë periudhës zgjedhore” të zëvendësohet me “gjatë fushatës zgjedhore”. Votojmë së pari propozimin e zotit Çaka! Janë kolegët në linjë? Zoti, Çela, zonja Vukaj, zoti Çakaj, jo vetëm po kërkoj të verifikoj praninë në momentin e votimit. Zoti Çakaj, zonja Vukaj, ndoshta kanë ndonjë problem.

Z.M.Çakaj: Jo, nuk kemi problem, jemi prezent...

Znj.I.Nano: Ok, në rregull! Atëhere, janë dy propozime së pari tek pika 1 e nenit ... së pari është propozimi i zotit Çaka për të zëvendësuar togfjalëshin “gjatë periudhës zgjedhore” me togfjalëshin “gjatë fushatës zgjedhore”. Ndërkohë është edhe propozimi i zotit Çakaj për ta zëvendësuar atë me “periudhën para dhe gjatë zgjedhjeve”. Zoti Çakaj jam korrekt me propozimin tuaj?

Z.M.Çakaj: Po, po. Përpara dhe gjatë....

Znj.I.Nano: Përpara dhe gjatë fushatës ... Po, “ përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore”. Së pari votojmë propozimin e zotit Çaka! Unë jam dakord, atëhere 3 vota pro... Po zoti Çakaj?

Z.M.Çakaj: Po, po dakord jemi, me gjatë fushatës. Që të zëvendësohet fjala me periudhë zgjedhore me fushatë zgjedhore jemi dakord sepse nuk ka sens periudha zgjedhore.

Znj.I.Nano: Atëhere, edhe njëherë ju ftoj kush është dakord me propozimin!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Kush është dakord?

Pro: 4 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, z. Çakaj)

Kundër: 1 (znj.Vukaj)

Atëhere, me 4 vota pro, 1 kundër miratohet....

Znj.H.Vukaj: E keqkuptuat sepse tani jemi në kushtet ku dora nuk e di unë në çfokus vendoset, por ishim tek pro-ja tek....

Znj.I.Nano: Në rregull!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj,z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

Atëhere, me 5 vota pro, miratohet zëvendësimi i togfjalëshit “periudhë zgjedhore” me “fushatë zgjedhore”.

Propozimi i zotit Çakaj, për zëvendësimin tashmë, për...

Z.M.Çakaj: Për shtesën... se tashmë është miratuar...

Znj.I.Nano: Për shtesën e... Ju lutem edhe njëherë propozimin tuaj në këto kushte që

Z.M.Çakaj: Atëhere, tashmë që është miratuar pra, që është zëvendësuar “periudha zgjedhore” me “ fushatën zgjedhore”. Tani ngelet vetëm shtesë. Përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore. Se gjatë fushatës zgjedhore sapo e miratuam

***Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

propozimin. Pra, propozimi në thelb gjysëm është i miratuar, “gjatë fushatës zgjedhore” thjesht duhet hedhur për votim, fjala “përpara” edhe “gjatë” fushatës.

Znj.I.Nano: Po, kolegë! Pra, fjala gjatë zgjedhjeve...

Z.M.Çakaj: “Gjatë fushatës” u miratua!

Znj.I.Nano: Po, jemi tek propozimi “përpara” dhe “gjatë fushatës zgjedhore”, tek fjala “përpara”!

Z.M.Çakaj: Po!

Znj.I.Nano: Po, të nderuar kolegë! Ju lutem!

Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?

Zoti Çakaj, ju vetë jeni dakord me propozimin tuaj?

Pro: 4 (znj.Nano, z.Çela, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: 1 (z.Çaka)

Miratohet!

Ju lutem administratës të reflektojë dhe të bëjë dy në një, dy propozimet e votuara lidhur me këtë nen.

Atëhere, miratojmë në tërësi nenin 6 ju lutem! Po zonja Vukaj keni edhe ju propozimin tuaj!

Znj.H.Vukaj: Mendoj që të shtojmë një pikë në këtë nen. Ku ashtu siç cilësuam në nenin 4 që policia kriminale dhe forcat policore speciale apo ato komando, këtu të shtojmë pikë ku ti referohemi po këtyre forcave aq sa miratuam, të cilat nuk i

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

lejohe të angazhohen në procesin zgjedhor , qendrojnë të dislokuara brenda ambjenteve të selive respektive. Pra, ashtu siç është edhe në nenin 5. Neni 5: “Përmban dislokimin e tyre në ambjentet respektive” Kështu që meqenëse ne bëjmë lidhjen me nenin 4 të këtij akti. Atëhere, mendoj që të kemi një pikë të re për vendqendrimin e këtyre forcave speciale.

Znj.I.Nano: Në fakt në nenin 4 pika 5 është : “ Ndalohet kryerja e ushtrimeve ose manovrave ushtarake jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit gjatë gjithë fushatës zgjedhore”.

Znj. H.Vukaj: Po më lart, “Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet. Forcat e Ushtrisë ndalohen të kryejnë ushtrimë apo manovra ushtarake jashtë dislokimit të tyre gjatë gjithë fushtës zgjedhore”. Në meritë të këtyre dy pikave, meqenëse forcat komando i futëm si forca si forca speciale por në kushtet e ndalimit kemi edhe policinë kriminale, atëhere do të thoja që është e nevojshme dhe e shoh të nevojshme që të kemi një pikë të re ku të draftojmë apo të amendojmë duke thënë që këto forca të dislokohen brenda ambjenteve të komisariateve apo selive respektive.

Znj.I.Nano: Atëhere, jeni për një shtesë?

Znj. H.Vukaj: Për një shtesë ose një pikë të re.

Znj.I.Nano: Pikë të re pra pika 4 e nenit 6. Po, ju lutem edhe njëherë se do ta votojmë? Po!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj. H.Vukaj: Policia kriminale, forcat komando, e të tjerë, pra ideja është që mund të kemi edhe të tjera forca policore që nuk i lejohet, kjo do gjetur draftimi më mirë nga administrata. Pra, le të fillojmë me: “Policia kriminale, dhe forcat policore të ndaluara për tu përdorur të cilat nuk iu lejohet të angazhohen në procesin zgjedhor, qendrojnë të qendrojnë të dislokuara brenda ambjenteneve të selive respektive apo komisariateve”.

Znj.I.Nano: Në rregull, le të fillojmë me propozimin e zonjës Vukaj për një shtesë, shtesën e pikës, pra për vendosjen e pikës 4 në nenin 6 sipas propozimit të zonjës Vukaj. Kolegë!

Kush është dakord?

Pro: 2 (znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

Nuk Miratohet!

Kështu që votojmë nenin sipas përmbatjes së paraqitur dhe ndryshimeve të miratuara, dy ndryshimeve të miratuara.

Kush është dakord me nenin 6 në tërësi mbas dy ndryshimeve të miratuara?


Pro: 4 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.Çakaj)

Kundër: 1 (znj.Vukaj)

Miratohet!

Kalojmë tek neni 7. Komunikimi ndërmjet KQZ-së dhe Policisë së Shtetit. Kolegë kemi ndonjë propozim për ndonjë shtesë, ndryshim ju lutem? Nuk kemi pyetur përfaqësuesin e një subjekti politik që është i pranishëm në mbledhje nëse ka një propozim konkret.

**Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Z. A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Jo, nuk kam! Faleminderit!

Znj.I.Nano:Faleminderit!

Kalojmë në votim kolegë për nenin 7, sipas propozimit!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj,z. Çakaj)

Kundër: S'ka!


Miratohet!

Kalojmë në nenin 8, regjistri i posaçëm i veprave penale, në fakt është një risi e këtij akti, duke parë nën dritën e detyrave të reja të Policisë Shtetit edhe sipas Kodit Zgjedhor, regjistri i posaçëm për çdo njoftim dhe referim të veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Kemi ndonjë diskutim të nderuar kolegë? Po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Është i njëjti diskutim që bëra edhe tek neni 5 sepse kemi përsëri të cituar “periudhën zgjedhore”, tek pika 2.

Znj.I.Nano: Në rregull! Edhe unë për këtë nen kam, mendoj një shtesë të vogël duke qenë se flasim për një regjistër , mendoj që ti ngarkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, të përcaktojë me një akt të vet, formën dhe përmbajtjen e regjistrit! Sepse nesër ky regjistër do të kërkohet qoftë nga KQZ-ja qoftë nga subjektet zgjedhore. Pra, duke qenë dakord në parim me mbajtjen e një regjistri mund të shtojmë një fjali në fund të pikës 1. “Forma dhe përmbajtja e një regjistri përcaktohen me akt të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”. Propozimi im! Propozimi i zotit Çaka është për zëvendësimin e “periudhës zgjedhore”. Zoti Çakaj?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Z.M.Çakaj: Njësoj siç e shtuam edhe tek neni i mëparshëm edhe duke qenë në kuadër të propozimit tuaj se rregjistrimi i posaçëm do të miratohet me akt të posaçëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Të cilin si propozim unë e gjej me vend këtë por bëhet fjalë për një periudhë përpara dhe në këtë kontekst të riformulohet pika 2 “përpara” dhe “ gjatë fushatës zgjedhore” sepse ka të bëjë me evidentimin e rasteve në rregjistrimin e posaçëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

Znj.I.Nano: Ndoshta duhet ti referohemi në këtë rast edhe Kodit Penal, edhe ndryshimeve në Kodin Penal, lidhur me veprat penale në fushën e zgjedhjeve dhe periudhën që ato përfshijnë.

Z.M.Çakaj: Po, Kodi Penal bën fjalë për vepra penale në fushën e zgjedhjeve. Nuk e parashikon, nuk e lidh ngushtësisht me periudhën se kur kryhet vepra penale. Po lidhet me lëndën materiale të veprës penale.

Znj.I.Nano: Lidhet, lidhet edhe me periudhën, lidhet edhe me periudhën në mos gaboj. Megjithatë kemi tre propozime. Një, propozimi si në nenin para ardhës i zotit Çaka, për zëvendësimin e togfjalëshit “periudhë zgjedhore” me “fushatë zgjedhore”. Kemi propozimin e zotit Çakaj, për të shtuar “ gjatë” dhe “para” fushatës zgjedhore. Edhe një propozim i tretë për të shtuar një fjali “ Forma dhe përmbatja e rregjistrimit përcaktohet me akt të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë”. Votojmë së pari propozimin e zotit Çaka.

Kush është dakord me zëvendësimin e togfjalëshit “periudhë zgjedhore” me “fushatë zgjedhore”?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S’ka!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Miratohet!

Znj.I.Nano: Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?

Pro: 2 (zgj. Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: 3 (zgj.Nano, z.Çaka, z. Çela,)

Nuk Miratohet!

Znj.I.Nano: Propozimi i tretë është shtimi i fjalisë, pas fjalisë së parë të pikës 1, shtimi i fjalisë që unë propozova. “Forma dhe përmbajtja e regjistrit të përcaktohet me urdhër ose me akt të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka!

Miratohet!

Kështu që votojmë tashmë në tërësi nenin 8. Me dy ndryshime të miratuara!

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S’ka!

Miratohet!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj.I.Nano: Kalojmë në **nenin 9** materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore. Kemi atë që thamë rrezen e ndalimit prej 150 metrash që buron Kodi Zgjedhor për ndalimin e materialeve propagandistike. Të nderuar kolegë në se keni ndonjë propozim për ndonjë shtesë, apo ndryshim në këtë nen? Me sa shoh jo! Ju ftoj të votojmë nenin 9 me titull “materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore”.

Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 9 sië është propozuar/

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Miratohet me 5 vota pro neni 9.

Kalojmë në shqyrtimin e **nenit 10** Plani i masave.

Zonja Vukaj po!

Znj.H.Vukaj: Një propozim në pikën 1 të nenit “Plani i masave” Filloj të lexoj fjalinë sië është propozuar që të propozoj konkretisht fjalët që dua të shtoj. “Policia e Shtetit para fillimit të ushtrimit të detyrave të saj në shërbim të procesit zgjedhor dhe zgjedhjeve harton Planin e Masave për ruajtjen dhe sigurimin e ndërtesave ku kryhet administrim zgjedhor dhe mjediseve brenda dhe jashtë qendrës së votimit me rreze perimetrike 150 metra...” më pas vazhdon sië ishte. Pra, një shtesë tek rreshti i parë “procesit zgjedhor dhe”. “Brenda dhe jashtë” tek rreshti i tretë. Po në rreshtin e tretë “me rreze perimetrike 150 metra”. Në rreshtin e pestë pas fjalës “në shërbim të..” shtoj “procesit zgjedhor dhe” vazhdon fjala ekzistuese zgjedhjeve. Ky është propozimi im.

Znj.I.Nano: Pra, është një riformulim thënë më fjalë të tjera i pikës 1.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj.H.Vukaj: Po është një riformulim duke saktësuar edhe këto moment të cilat mendoj se janë të nevojshme.

Znj.I.Nano: Atëherë, ju lutem zonja Vukaj për efekt të regjistrimit lexojeni dhe njëherë që ta konsiderojmë votim për riformulim të pikës 1 të nenit 10.

Znj.H.Vukaj: Pika 1 “Policia e Shtetit para fillimit të ushtrimit të detyrave të saj në shërbim të procesit zgjedhor dhe zgjedhjeve harton Planin e Masave për ruajtjen dhe sigurimin e ndërtesave ku kryhet administrim zgjedhor dhe mjediseve brenda dhe jashtë qendrës së votimit me rreze perimetrike 150 metra si dhe shoqërimin e materialeve të votimit, për paisjen e punonjësve të Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyra në shërbim të procesit zgjedhor dhe zgjedhjeve me armatim sipas parashikimit të paragrafit të 2 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, paisjet e tjera të nevojshme për shërbim dhe me dokument e identifikimit sipas lidhjes 1 bashkëlidhur”.


Znj.I.Nano: Dakord, me propozimin e zonjës Vukaj, ka propozime të tjera për nenin 10 ju lutem?

Z.D.Çaka: Unë do të doja vetëm një sqarim ju lutem që në lidhje me propozimin t’i qëndrojmë po të njëjtës te distanca 150 metra, t’i qëndrojmë rastit përjashtimor

Znj.I.Nano: Pa çenuar sië është shprehja në nenin e përkufizimeve.

Z.D.Çaka: Siç e miratua në nenin e përkufizimeve.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj.I.Nano: Zonja Vukaj ju paraprkisht bashkoheni me këtë mendim të Zotit Çaka në mënyrë që ta votojmë?

Znj.H.Vukaj: Pa cënuar mundësinë e të tretëve apo...

Z.D.Çaka: Po.

Znj.I.Nano: Ateherë bashkoj dy në një propozimet e zonjës Vukaj për riformulimin e nenit të zotit Çaka për saktësimin sikundër është shprehur te neni i përkufizimeve pas rrezes 150 metra, pra pa cënuar rastin përjashtimor dhe ftoj kolegët për të votuar propozimet për ndryshimet në pikën 1 të nenit 10, të nderuar kolegë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


Kundër: S'ka

Miratohet me 5 vota pro miratohet neni 10 me riformulimin e pikës 1 të tij. Viojmë me nenin 11 "**Komunikimi dhe bashkërendimi i veprimeve të KZAZ-së me Policine e Shtetit**" Të nderuar kolegë , keni ndonjë?...Po zonja Vukaj

Znj.H.Vukaj: Në pikën 3 po në atë logjikë të shtesave apo rregullimeve që bëm në nenin 10, në pikën tre mendoj te shtojmë pas fjalës "*në mjedisin e brendshëm saktësimin e brendshëm apo të jashtëm te...*" dhe në pikën 4 "*Sekretari i KZAZ-së kryesisht ose me kërkesë të secilit anëtar të QV-së vë në dijeni menjëherë KQZ-në*" Këto dy propozime kisha, le të themi shtesa.

Znj.I.Nano: Pra në pikën tre ju thoni në mjedisin brenda dhe jashtë të cilës

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj.H.Vukaj: Ku është QV-ja

Znj.I.Nano: Më lejoni të bëj komentin tim para nëse dhe kolegët mund të kenë. Pra bëhet fjalë për vendodhjen e KZAZ-së në mjedisin e sëcilës është raportuar se është rrezikuar rendi ose pengohet procesi i rregullt i votimit. Besoj se kjo është e lidhur dhe me detyrimet e nenit ...

Znj.H.Vukaj: Komunikimi dhe bashkërendimi i veprimeve të KZAZ-së me policinë e shtetit dhe pika 3 thote: “Sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për njoftimin e drejtorit të Policisë Vendore dhe ose shefit të Komisarariatit të Policisë që mbulon territorin ku ka vendodhjen QV-ja në mjedisin e brendshëm ose të jashtëm të sëcilës është raportuar se rrezikohet rendi ose pengohet procesi i rregullt i votimit. Ky njoftim i bëhet me dije dhe anëtarëve të KZAZ-së. Pra, mendoj se qëndron për shkak se ne e kemi saktësuar në nenet të cilat sapo i kemi miratuar që bëhet fjalë gjithmonë për veprimin aktiv të policisë dhe ndërhyrjeve të saj apo vëzhgimin e saj në mjedisim e brendshëm dhe të jashtëm”

Znj.I.Nano: Unë do të doja që këtë ta shihnim në raport dhe do të doja ndihmën e zonjës Tenolli në raport me një akt të mëhershëm që ne kemi miratuar dhe me referencën konkrete në Kodin Zgjedhor për rastet e njoftimeve të policisë së shtetit dhe po t'i referohemi dhe një momenti tjetër ligjor është fakti që policia merr përsipër të ruaj selinë e KZAZ-së nga momenti kur mbërrijnë materialet zgjedhore dmth 3 ditë para ditës së zgjedhjeve. Prandaj është ajo që ne diskutuam që ka detyra gjatë 4 muaj para zgjedhjeve, ka detyra gjatë fushatës zgjedhore dhe ka detyra që janë të mirëpërcaktuara me afate në Kodin Zgjedhor. Zonja Tenolli kam përshtypjen që nuk dëgjoheni.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj.A.Tenolli: Ndjesë!

Znj.A.Tenolli: Duke besuar që nuk jam dëgjuar më parë... Sa i përket përcaktimit të paragrafit të tretë të nenit 11, është përcaktuar vetëm mjedisi i brendshëm i qv-së për arsye se KQV-ja përgjigjet për zhvillimin dhe administrimin e procesit në mjedisin e qendrës së votimit dhe në këtë kuadër ai i bën njoftimet KZAZ-së vetëm për fenomene dhe ngjarje që çënojnë rregullin e votimit në mjedisin e qendrës së votimit. Në qoftë se do të referojmë edhe situata problematike jashtë qendrës së votimit atëherë nga kush do ta merrte njoftimin Sekretari i KZAZ-së. Sa i vërtetë do të ishte ky njoftim i marrë nga shtetas, qytetarë që do të jetë me dozë vërtetësie, ose jo, do të mund të krijojnë alarme viktime të rreme dhe do të kishim një ekspozim ndoshta dhe të panevojshëm të punonjësve të policisë në rrethinat e ambjenteve ku kryhet votimi.

Znj.H.Vukaj: Po në rastin zonja Tenolli, kur kemi prishjen e rendit dhe të qetësisë, jashtë atij ambjenti që ju presupozuat dhe ndërkohë bie në kundërshtim me citimin që ju keni thënë në rreshtin e dytë "Sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për njoftimin e Drejtorit të Policisë Vendore, ose shefit të komisariatit të policisë që mbulon territorin ku ka vendndodhjen qv-ja. Pra, lidhet me rolin që do të ketë tashmë policia si një risi. Pra, jo vetëm brenda ambjenteve të qv-së, por dhe jashtë ambjenteve të saj. Në konceptin e territorit dhe rrezes 150 metra. Çfarë do të ndodhte në rast se një incident jashtë ambjenteve të brendshme të qv-së do të shërbente më pas si rrezik për prishjen e procesit zgjedhor dhe kështu me rradhë. Do ta evitonte, apo nuk do ta merrte në konsideratë sekretari i qv-së për të njoftuar Policinë e Shtetit?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita BULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Z.M.Çakaj: Më falni që ndërhyj, kam përshtypjen që shqetësimi i zonjës Vukaj është i drejtë, por kam përshtypjen se reflektohet në nenet që vijnë në vijim. Tek roli dhe detyrat e Policisë së Shtetit jashtë qendrës së votimit. Janë nenet në vijim që do të sqarojnë të gjithë rolin dhe detyrat qoftë të sekretarit apo anëtarëve të qv-së si dhe rolin dhe detyrat e ngarkuara Policisë së Shtetit. Shqetësimi i zonjës Vukaj është me vend, por kam përshtypjen se adresohet në nenet që do të vijnë pak më vonë në diskutim.


Znj.I.Nano: Po zoti Çakaj, i bashkohem komentit tuaj duke pasë parasysh shqetësimin e drejtë të zonjës Vukaj, por nga ana tjetër duke pasë parasysh edhe faktin që as KQV-të, as KZAZ-të s'kanë juridiksion jashtë ambjenteve të ushtrojnë funksionet e tyre, detyrat e tyre. Kjo do të thotë ambjentet ku ndodhet KZAZ-ja dhe KQV-ja. Megjithatë dhe njëherë do t'i votojmë tek e tek, sepse ka një shtesë zonja Vukaj në pikën 3 dhe një në pikën 4 të të njëjtit nen, apo jo?

Znj.H.Vukaj: Po po!

Znj.I.Nano: Së pari votojmë ndryshimin e propozuar të zonjës Vukaj që lidhet me pikën 3 të nenit 11. "Në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm". Votojmë të nderuar kolegë? Kush është pro propozimit të zonjës Vukaj?

Z.M.Çakaj: Më fal, sapo e sqaruam, kam përshtypjen që nuk jemi në kushtet, duhet ta thotë vetë zonja Vukaj, nuk jemi në kushtet e propozimit. Shqetësimi I zonjës Vukaj reflektohet dy nene më poshtë dhe gjen pasqyrim. Të mos ndërhyjmë kot në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

këtë nen, ndërkohë e gjej me vend shqetësimin që sqarohet më poshtë. E gjejmë të zberthyer dhe materializuar më poshtë. Ftoj zonjën Vukaj..

Znj.I.Nano: I takon zonjës Vukaj të tërhiqet nga propozimi, në të kundërt unë duhet ta shtroj për votim.

Znj.H.Vukaj: Vlerësoj ndërhyrjen e të dy zotërinjëve, zonjës Tenolli, zotit Çakaj por edhe të zonjës Nano, e cila për korrektësi shkon në vijueshmëri të zbatimit të rregullores, jam koshiente që ato janë më poshtë, por në meritë të një draftimi më cilësor, mendova ta implementonim edhe këtu. Jam dakord që akti mund të qëndrojë edhe pa këto dy fjalë, por mendova që cilësisht mund të ishte më mirë për një lexues që do ta zbatojë këtë akt. Kështu që për të mos penguar gjithë procesin le të vazhdojmë me pikën 4 ku unë bëra një shtesë tjetër “kryesisht, ose nga secili anëtar i qv-së”.

Znj.I.Nano: Zonja Vukaj, edhe njëherë të lutem propozimin tuaj?

Znj.H.Vukaj: Sekretari i KQV-së kryesisht, ose me kërkesë të secilit anëtar të qv-së, ve në dijeni menjëherë KQZ-në, në të gjitha rastet kur është kërkuar ndërhyrja e punonjësit të policisë”. Shtesa është “kryesisht, ose me kërkesë të secilit anëtar të qv-së”. Mendoj se do t’i japë cilësinë e duhur dhe mundësinë literale që palët ta lexojnë në përputhje me të drejta

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zj. Vukaj: Shtesa është kryesisht ose me kërkesë të secilit anëtar të QV. Mendoj se do t'i japë cilësinë e duhur dhe mundësinë literale që palët ta lexojnë në përputhje me të drejtat që kanë.

Zj. Nano: Atëherë unë do t'i drejtohesha pra edhe njëherë Zj. Tenolli, për shkak se ne kemi miratuar një akt dhe kemi përcaktuar detyrat e anëtarëve, sekretarëve të KZAZ dhe KQV, kështu që në këtë rast do të doja që të shikonim nëse është e harmonizuar. Do t'ju lutesha kolegëve Zj. Vukaj nëse ju meqenëse jeni propozuesja, e doni që të kalojmë një nen më poshtë dhe derisa Zj. Tenolli të verifikojë në raport me një akt të menjëhershëm që kemi miratuar.

Zj. Vukaj: Absolutisht që po.

Zj. Nano: Zj. Tenolli nuk dëgjoheni, ju lutem.

Zj. Vukaj: Në fakt rezulton ta ketë të mbyllur audion.

Z. Merkaj: Hapur hapur është.

Zj. Tenolli: Atëherë mendoj që është i harmonizuar sepse dhe në aktin që ju keni miratuar më përpara për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor është përcaktuar qartë detyra e sekretarit të KZAZ për të bashkërenduar veprimet me Policinë e Shtetit dhe për të administruar dhe ruajtur të gjithë dokumentacionin që kryhet/ realizohet me këto si më lart.

Zj. Nano: Jemi duke folur për një gjë tjetër, tek detyrat e sekretarit.

Zj. Tenolli: Të KZAZ

Znj. Nano: Po të KZAZ. Ne do të kalojmë në shqyrtimin e nenit pasardhës. Unë do t'ju lutesha të shikonit pikën 4 të nenit 11, në raport me aktin që kemi miratuar,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

pra sekretari i KZAZ vë në dijeni menjëherë KQZ, në rastet kur është kërkuar ndërhyrja e punonjësit të policisë, është parashikuar në projektakt. Zj. Vukaj propozon kryesisht, ose me kërkesë të /do anëtari. Unë e kam kërkesë si anëtare e Komisionit Rregullator që para së të votojë propozimin ta shohë si e kemi përcaktuar këtë detyrë në aktin paraardhës, kështu që sapo të jeni gati, ju lutem kërkon fjalën. Ne po kalojmë në nenin 12 “ Ruatja e ndërtesave ku kryhet administrimi zgjedhor”. Kolegë, nëse keni propozime, kërkesa, propozime për shtesa apo ndryshime në këtë nen. Mendova se z.Çakaj kërkoj fjalën po ndoshta jame e gabuar. Atëherë z. **Tenolli** tani dëgjoheni ndërkohë që ne jemi duke folur kështu që ju lutem, faleminderit. Atëherë kolegë lidhur me neni 12 po shoh që nuk keni propozime për shtesa apo ndryshime. Të kalojmë në votimin e nenit 12-të ju lutem, kush është dakort?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 12-të.

Kalojmë te neni 13-të “Lejimi i punonjësit të policisë për tu futur në mjedisin e qendrës së votimit dhe mjediset jashtë qendrës së votimit” .Komente , diskutime për shtesa apo ndryshime, propozime? Shoh që nuk kemi propozime konkrete, atëherë le të votojmë nenin 13-të sipas draftit të propozuar. Të nderuar kolegë kush është dakort me neni 13-të?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z. Çaka,z.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Me 5 vota pro miratohet neni 13-të. Kalojmë në shqyrtimin e nenit 14-të “Rendi në mjediset e jashtme të qendrës së votimit”. Personalisht kam të njejtin diskutim që bëra më herët pra duke patur parasysh atë rezen 150m ku kemi vendosur përjashtimin të mos lejohet cënimi i pronësisë po themi apo disponimit të lirë të pronës. Këtu kemi një ndalim që mua më duket se shkon përtej atyre çka duam ne të realizojme nëpërmjet këtij akti. Pra kemi ndalimin në mjediset jashtë qendrës së votimit në pikën 1, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj në koridoret e brëndëshme të ndërtesës dhe rreth qendrës së votimit dhe në një rrezë prej 150m nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave përveç zgjedhësve që presin në rradhë për të votuar. Do të isha shumë dakort me grumbullimin pra të mos lejohet grumbullimi, por prania mund të jetë dhe prani e rastësishme si kundër thamë mund të jetë një rrugë kalimi, mund të jetë një godinë banimi, sa për grumbullimin jam totalisht dakort për praninë propozoj që ta heqim. Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë propozim të ngjashëm për këtë pikë apo për pika të tjera.

Znj. Vukaj: Personalisht mbetem propozimit literal të më hershëm të propozuesit pra komisionerit në këtë rast, për shkak se ajo është një ditë dhe e vetme me një orarë të caktuar dhe e drejta e votës prevalon mbi çdo të drejtë tjetër, kështu që ne nuk kemi parasysh as atë akt që as do cënohet pronësia e dikujt posedimi i qetë apo të drejta të tjera thjeshtë kjo është vetem një garanci e shtuar e asaj dite. Ne po e dimë shumë mirë që e drejta e lirisë le të themi të mëparshme është e kufizuar edhe në kushte pandemia apo në këto rrethana nëpër të cilat pse sepse prevalon edhe në këtë rast duke qënë se e drejta e votës është një e drejtë prevalente meriton të ketë ca garanci më shumë. Kështu që personalisht i mbetem propozimit të ardhur.

Znj.Nano: Atëherë nëse ska propozime të tjera, po z.Çaka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Z. Çaka: Atëherë unë në këtë pikë jam dakord me propozimin tuaj znj.Nano për tu hequr prania sepse ajo mund të jetë dhe rastësore dhe do të shtonim te kjo pike edhe vazhdoj ti qëndroj ati qëndrimit dhe të mëparshëm që shtohet përjashtimi në fund të fjalisë pra përjashtimi I rasteve sepse mund të kemi dhe grumbullime të personave të pranisë tek një pronë që mund të kemi ngjitur ndërkohë meqë më lejove që mos ta marr më prap fjalën, tek pika e 6 mendoj se mund të ketë një gabim, mbase më korigjoni. Aty ku thuhet sekretari vepron në përputhje me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 10 –të të këtyre rregullave. Kam idenë që duhet të jetë neni 11 që ka të bëjë me komunikimin dhe bashkpunimin, sepse neni 10 mos gaboj është plani I masave të policisë së shtetit.

Znj.Nano: Është neni 11-të të cilin lamë për të diskutuar por në fakt në 11-tën janë detyrat e sekretarit të Kqz-së.

Z.Caka: Unë mendoj që ky mund të jetë thjeshtë një lapsus , mbase dhe administrata e Kqz-së e verifikon dhe na e konfirmon kjo ishte thjeshtë pa problem, ndersa te pjesa tjetër pra jam dakort me propozimin tuaj dhe do doja që të kishte një propozim që të shtohet ajo fjalia e rastit përjashtimore, faleminderit.

Znj.Nano: Atëherë nga administrata z.Tenolli dhe unë tani sapo e verifikova këtë që tha z.Çaka bëhet fjalë për nenin 11-të jo për nenin 10-të të rregullave kështu që kolegë shtë një korigjim nuk po e quajmë propozim për ndyshim që të mos votojmë. Dakort jeni me këtë saktësim? Ok atëherë mbetet vetën një propozim për tu votuar në këtë nen ose 2 më mirë të themi, 1 për të cilin kemi rënë dakort edhe më herët për të vendosur atë përjashtimin në një rreze prej 150m duke vendosur përjashtimin e parashikuar dhe të votuar nga ana jonë në nenin 2 dhe propozimi im është të hiqet fjalia prania dhe të mbetet fjalia grumbullimi. Nuk

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

lejohet grumbullimi i personave pra të hiqet fjala prania. Kush është dakort ju lutem me këtë propozim? Znj. Vukaj nuk dëgjoheni ju lutem.

Znj. Vukaj: Ndjesë në lidhje me fjalën prania dhe argumentin pse jam kundër referuar precedentëve fjala prania lidhet me praninë e identifikuar më herët të personave të cilët në meritë të fjalës zgjedhës apo të cilësimit si zgjedhës në një qendër votimi me praninë e tyre ndikojmë apo bëjmë presion për votën atë ditë. Pra mund të rrinë në rradhë dhe nga ana tjetër justifikojnë veten duke ndenjtur në rradhë dhe nga ana tjetër justifikojnë po kështu fjalën prania dhe gjatë këtij procesi ato nuk bëjnë gjë tjetër vecse ndikimin rastësorë ose ndikimin e qëllimshëm të grupeve të caktuara apo të njerëzve të caktuar ditën e votimit në lidhje me votën e tyre. Mund të jenë punonjës të administratës publike, shtetërore e kështu me rradhe. Këto janë raste të ekspozuara nga e kaluara mediatikisht kështu që besoj se draftuesit i kanë në konsideratë prandaj kanë përdorur fjalën prania faleminderit.

Znj.Nano: Faleminderit, atëherë votojmë për propozimin për të hequr fjalën prania nga fjalia konkrete pra të mbetet grumbullimi. Kush është dakort ju lutem?

Pro: 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

Kundër: (znj.Vukaj, z.Çakaj)

Atëherë me 3 vota pro 2 kundër nuk miratohet propozimi për tu hequr fjala prania, do më duhet të kërkoj konfirmimin tuaj për një gjë që tashme e keni votuar për shtimi e përjashtimit të parashikuar të përkufizimet edhe këtu sa I përket rrezes 150 m gjithmonë në funksion të mos cënimit të pronësisë. Pra ajo formulë që është parashikuar.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Znj. Vukaj: Po ndoshta duket e tepërt z.Nano sepse është thënë disa herë edhe përkufizimi domethënë duket sikur po e ngarkojmë normat apo pikat më shumë nga çduhet. Ajo është e qartë që në përkufizim.

Znj.Nano: Atëherë z.Çaka i mbeteni propozimit për të shtuar formulën e përjashtimit?

Z.Çaka: Po sepse ne e kemi ndjekur dhe më para këtë praktikë.

Znj.Nano: Të gjitha dispozitat ku është parashikuar 150m rrezia.

Z.Çaka: Diçka më sqaruese aq më tepër në të tilla raste do të ishte më mirë. Unë i qëndroj propozimit tim.

Znj.Nano: Atëherë votjme ju lutem propozimin e z.Çaka që pas fjalës 150 m të përdoret përjashtimi i përcaktuar në neni n 2 të këtij akti përkufizimet. Kush është dakort ju lutem?

Pro: 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

Kundër: (znj.Vukaj, z.Çakaj)

Nuk miratohet propozimi i z.Çaka, atëherë më lejoni të nderuar kolegë meqenë se patën dy propozime të rrëzuara të votojmë në terësi nenin 14-të. Kush është dakort tashme me nenin 14-të sipas propozimit të komisionerit për të mos penguar vijimin e mëtejshëm dhe miratimin e neneve me rradhë edhe unë jam dakort me nenin 14-të si kundër është propozuar.

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Miratohet neni 14-të.

Vijojmë me nenin 15-të shoqërimi I kutive të votimit dhe materialeve të votimit në vendet e numërimit të votave. Kolegë ju ftoj të bëni propozime për shtesa apo ndryshime nëse keni, shoh që nuk kemi diskutime për këtë nen kështu që do doja të kalonim në votimin e nenit 5-të.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zj.I.Nano: Do kalonim në votimin e **nenit 15**, kush është dakord me nenin 15, sipas propozimit? *Me 5 (pesë) vota pro miratohet neni 15.*

Kalojmë te **neni 16**, “Lejimi i punonjësit të Policis së Shtetit, për tu futur në ambientet e vendeve të numërimit të votave”. Keni ndonjë diskutim për këtë nen, ndonjë propozim konkret për shtesë apo ndryshim? Shikoj që asnjë nga kolegët nuk ka propozime, kështu që duhet të kalojmë në votimin e nenit 16 kush është dakord me nenin 16 sipas propozimit të Komisionerit? *Me 5 (pesë) vota pro miratohet neni 16.*

Vijojmë me **nenin 17** “Rendi dhe siguria në ambientet e jashtme dhe Vendit të Numërimit të Votave”, kemi propozime për ndryshime në këtë nen? Nuk kemi, atëherë duhet të kalojmë në votimin e nenit 17, me titull “Rendi dhe siguria në ambientet e jashtëm të Vendeve të Numërimit të Votave”, kush është dakord me propozimin, me aktin si kundër është sjellë nga propozuesi . *Me 5(pesë) vota pro miratohet neni 17.*

Kalojmë në **nenin 18**, “Lëvizjet e policisë” kemi ndonjë propozim konkret? nuk kemi.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord me nenin 18, sipas draftit të ardhur ?

Me 5(pesë) vota pro miratohet neni 18.

Neni 19 janë “Sanksionet”, më lejoni ta lexoj sepse vetë kam një paqartësi “Shkelja e rregullave të këtij’ çfarë do të thotë të këtij? të parashikuara në ligjin nr.10019, të “ Kodit Zgjedhor”, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe rregullave të këtij akti apo akteve të tjera të miratuara nga Komisioni Qendror i

*Zbardhi materialin e inçizuar
Vezjona Sula*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zgjedhjeve, përgjatë periudhës të parashikuar në paragrafin 8, neni 2 i këtij akti, kur nuk përbën vepër penale përbën kundravajtje administrative dhe dënohet sipas sanksionit administrativ të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor. Përveç hartimit nga këndvështrim gramatikor që kërkon një rregullim nga ana e administratës së KQZ-së. Unë kam një koment të referencat të Ligji i Policisë së Shtetit, pra ne ngarkojmë me, konsiderojmë kundravajtje administrative apo vendosim sanksione, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 171, kemi shkeljen e dispozitave të këtij Kodi, nga anëtarët e Komisioneve të Zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuara me detyra, që do të thotë këto sanksione burojnë nga Kodi Zgjedhor, nuk burojnë nga zbatimi ose jo i ligjit të Policisë së Shtetit dhe aktet që ne miratojmë mund t'i referohemi Kodit Zgjedhor të Sanksioneve. Nëse shkelet ligji i Policisë së Shtetit ka rregulla të tjera ka sanksione të tjera, mendimi im personal, pra “referencat të ligji i Policisë së Shtetit”, do të propozoja ta hiqim, sepse mund të gabojmë me sanksionet që vendosim këtu mund të ketë sanksione të tjera .

Z. D.Çaka: Edhe unë e gjej me vend ndërhyrjen tuaj zj. Nano.

Zj.I. Nano: Përsa i përket Kodit Zgjedhor dhe akteve që miratojmë ne i referohemi sanksioneve të parashikuara në nenin 171 të Kodit Zgjedhor, ndërsa gramatikisht dhe gjuhësisht do të kërkoja nga administrata e KQZ-së rregullimin e nenit. Atëherë koleg ka propozim tjetër për këtë nen? Jo!

Atëherë, ka vetëm një propozim “për heqjen e referencës në ligjin e Policisë së Shtetit, duke iu referuar sanksioneve të vendosura në Kodin Zgjedhor .

Kush është dakord me këtë propozim, ju lutem ?

Tre vota pro (zj. Nano, z. Cela, z. çaka).

*Zbardhi materialin e inçizuar
Vezjona Sula*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Kundër? Dy vota kundër(*Zj. Vukaj, z. Çakaj*),

Nuk miratohet ky propozim, nëpërmjet mos miratimit të këtij propozimi .

Sapo ju thamë të gjithë strukturave që zbatojnë ligjin e Policisë së Shtetit, që njerëzit dënojnë nga 30 mijë leke deri në 90 mijë lekë gjobë, nëse shkelin ligjin e Policisë së Shtetit që në thelb kjo është një dispozite e pa zbatueshme për ta.

Atëherë, i rikthehem **nenit 11**, zj. Tenolli në nenin 11 në pikën 4, zj. Vukaj kërkoi të shtonte fjalën “Kryesisht” ose “Me kërkesë të çdo anëtari të KAZ-s” nga ana ime u kërkua që të shikonit aktin që ne kemi miratuar më herët për detyrat, ku përcaktohen edhe detyrat e sekretarit të KZAZ-së, për ta harmonizuar. E keni gjetur ndërkohë aktin mund të na citoni dispozitën konkrete, lidhur pikërisht me këtë detyrë të Sekretarit të KZAZ-së .

Zj. Tenolli: Atëherë referenca është në vendimin e Komisionit Rregullator, vendimi nr. 5 datë 20.11.2020, Për Miratimi e Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e KZAZ-së, konkretisht, dispozita është me numër 14 paragrafi 2, shkronja “h”, ku përcaktohet detyrë për sekretarin e KZAZ-së , sipas këtij vendimi të Policisë së Shtetit të masave të rendit publik në funksion të zgjedhjeve .

Zj.I. Nano: Ka të përcaktuar konkretisht detyrën e aktit që ne kemi miratuar, Sekretari I KZAZ –së vë me një herë në djeni KQZ-në në të gjitha rastet kur është kërkuar ndërhyrja e punonjësit të Policisë së Shtetit për rivendosjen e rendit. Si është hartuar dispozita që kemi miratuar zj. Tenolli ?

Zj.A.Tenolli: Atëherë, në këtë dispozitë, të titulluar: “Detyrat e anëtarit të KZAZ-së dhe të sekretarit të KZAZ-së, në paragrafin 1 të saj rend dite, janë detyrat e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Vezjona Sula*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

anëtarit të KZAZ-së , ndërsa ato të Sekretarit i cili ka detyra shumë të rëndësishme, administrative dhe të dokumentimit të çdo veprimtarie, situatë apo rasti, renditen detyrat përkatëse të Sekretarit ,në pikën “ h” të detyrave të sekretarit.

Citoj: Akti përcakton, bashkërendon me Policinë e Shtetit masat për rendin publik në funksion të zgjedhjeve, detyrë e buruar nga përcaktimet e nenit 34 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen detyrat e Sekretarit të KZAZ-së, por nuk shprehet këto detyra, detyrim i Sekretarit të KZAZ-së. Për të njoftuar Komisioni Qendror të Zgjedhjeve kur është cënuar rendi është kërkuar ndërhyrja e policisë, në mjediset e brendshme apo në rrethina të tjera të administrimit zgjedhor, përcaktohet detyrë vetëm bashkërendimi i masave me policinë .

Zj.I. Nano: Ok, faleminderit!

Pra, kjo është një detyrë e shtuar e Sekretarit të KZAZ-së, përveç aktit të posaçëm ku përcaktohen detyrat e anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së, në këtë akt është një detyrë e posaçme ‘vë në djeni menjëherë’.

Atëherë hedhim në votim propozimin e zj. Vukaj . “Kryesisht” ose “ me kërkesë të çdo anëtari të KZAZ-së, vënë djeni dhe vijon fjalia.

Jemi te pika katër zj. Vukaj .

Zj.H.Vukaj: Sekretarit të KZAZ-së kryesisht ose me kërkesë të secilit anëtar të KZAZ-së vë në djeni, po , ndjesë!

Zj.I.Nano : Atëherë kush është dakord me propozimin e Zj. Vukaj?

Pro 5 (pesë): Zj. Vukaj, Z. Çakaj; Kundër: Z. Cela, Z. Çaka, Zj. Nano.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Vezjona Sula*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

Zj. I. Nano: Nuk miratohet ky propozim, kështu që na duhet ta, nëse nuk ka propozime të tjera, kaluam edhe pikat e tjera të nenit 11, votojmë nenin 11 në tërësi, ju lutem. Kush është dakord me nenin 11?

Me 5 (pesë) vota pro miratohet edhe neni 11.

Atëherë shkojmë.

Z.M. Çakaj: Neni 20.

Zj.I. Nano: Pas sanksioneve kemi nenin e fundit, "Shfuqizimet dhe hyrja në fuqi". Pra, shfuqizohet vendimi i mëparshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe hyrja në fuqi që tashmë bëhet menjëherë dhe akti publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Zj. I. Nano: Kush është dakord, të nderuar kolegë, me nenin 20?

Me 5 vota pro miratohet edhe neni 20.

Pasi kemi miratuar në parim projektvendimin, e kemi shqyrtuar dhe miratuar nen për nen, me disa ndryshime në nene të caktuara, është momenti të votojmë në tërësi projektvendimin.

Të nderuar kolegë kush është dakord me projektvendimin?

Faleminderit!

Me 5 vota pro sapo kemi miratuar projektvendimin "Për veprimtarinë, rregullat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve". Duke qenë që nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës, unë do të mbyllja tashmë mbledhjen, është mbledhja e fundit e këtij viti, kështu që para se të mbyllnim mbledhjen do të ftoja edhe kolegët nëse kanë urime për të përcjellë. Së pari do të doja të përcillja urime

*Zbardhi materialin e inçizuar
Vezjona Sula*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.30.12.2020*

për festa të gëzuara për të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Komisionerin dhe Nënkomisioneren Shtetëror të Zgjedhjeve, administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për kolegët e Komisionit të Sanksioneve dhe Ankimimeve, që na ndjekin rregullisht online në mbledhjet tona dhe për të gjithë mediat që na kanë ndjekur gjatë gjithë kësaj veprimtarie, por dhe për të gjithë publikun, uroj nga zemra festa të gëzuara dhe një fillim të mbarë të vitit 2021.

Të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator urojnë Gëzuar.

Zj. I. Nano: Atëherë e deklaroj të mbyllur mbledhjen. Mirupafshim.

Vendimi nr.12

*Zbardhi materialin e inçizuar
Vezjona Sula*

